

VENDIM
Nr. 62/2025

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES DHE PROGRAMIT POLITIK
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të neneve 78, 95, 96, 97, 98 të Kushtetutës, të nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 333, datë 15.9.2025, “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e Këshillit të Ministrave si më poshtë:

- | | |
|--|---|
| 1. Zoti Edi Rama | Kryeministër |
| Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e Ministrit Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella”. | |
| 2. Zonja Belinda Balluku | Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë |
| 3. Zonja Albana Koçiu | Ministër i Punëve të Brendshme |
| 4. Zonja Elisa Spiropali | Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| 5. Zoti Petrit Malaj | Ministër i Financave |
| 6. Zoti Blendi Gonxhja | Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit |
| 7. Zoti Sofjan Jaupaj | Ministër i Mjedisit |
| 8. Zonja Mirela Kumbaro Furxhi | Ministër i Arsimit |
| 9. Zonja Evis Sala | Ministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale |
| 10. Zonja Delina Ibrahimaj | Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit |
| 11. Zoti Besfort Lamallari | Ministër i Drejtësisë |
| 12. Zoti Pirro Vengu | Ministër i Mbrojtjes |
| 13. Zoti Andis Salla | Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| 14. Zoti Ervin Demo | Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor |
| 15. Zonja Majlinda Dhuka | Ministër Shteti dhe Kryenegociator |
| 16. Zonja Adea Pirdeni | Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin |
| 17. Zoti Toni Gogu | Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin |

II. Miratohet programi politik i Këshillit të Ministrave sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 18.9.2025.

PROGRAMI QE VERISËS 2025–2029

Përmbajtje

Preambulë

Shtylla I. Shqipëria evropiane

Shtylla II. Rritja ekonomike e qëndrueshme

Shtylla III. Mirëqenie për të gjithë

Shtylla I. SHQIPËRIA EVROPIANE

1.1 Anëtarësimi në Bashkimin Evropian

1.2 Shteti digjital dhe siguria kibernetike

1.3 Administrata publike, antikorrupsioni dhe transparencë

1.4 Drejtësia dhe të drejtat themelore

1.5 Politika e jashtme dhe diaspora

1.6 Mbrojtja dhe siguria kombëtare

1.7 Siguria publike

Shtylla II. RRITJA EKONOMIKE E QËNDRUESHME

2.1 Financat publike dhe politika fiskale

2.2 Politikat për biznesin

2.3 Inovacioni dhe teknologjia

2.4 Puna dhe kapitali njerëzor

2.5 Infrastruktura moderne

2.6 Turizmi

2.7 Bujqësia dhe zhvillimi rural

2.8 Energjia

Shtylla III. MIRËQENIE PËR TË GJITHË

3.1 Arsimi dhe formimi profesional

3.2 Shëndetësia

3.3 Familja, politikat sociale dhe strehimi

3.4 Pensionet

3.5 Fëmijët, rinia dhe barazia gjinore

3.6 Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike

3.7 Pushteti vendor dhe zhvillimi rajonal

3.8 Sporti

3.9 Kultura

Preambulë

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030 është misioni ynë kombëtar, është kryefjala e çdo vendimi, është boshti i çdo reforme, është ëndrra e brezave që ne kemi marrë përsipër ta kthejmë në realitetin e brezit tonë. Ky nuk është një udhëtim protokollesh e ceremonish, por një proces i thellë shtetformimi, që e bën Shqipërinë më të drejtë, më të fortë, më moderne dhe më të denjë për të ecur krah për krah me kombet e zhvilluara të Evropës.

Shqipëria evropiane është shtylla e parë dhe busulla që i jep drejtim çdo reforme. Anëtarësimi nuk është vetëm objektiv diplomatik, por proces transformues që forcon shtetin e së drejtës, modernizon shtetin digjital, rrit integritetin e administratës, garanton sigurinë publike dhe kombëtare, dhe e vendos Shqipërinë në zemër të vendimmarrjes evropiane. Evropa mbi të gjitha është përfitimi

i drejtpërdrejtë për qytetarët, në jetën e tyre të përditshme – në punën që bëjnë, në shërbimet që marrin, në të drejtat që gëzojnë dhe në sigurinë që ndiejnë, si pjesë e një familjeje me 450 milionë anëtarë.

Rritja ekonomike e qëndrueshme është shtylla e dytë dhe rruga që kthen vizionin në realitet. Shqipëria e re ndërtohet mbi financa të shëndosha dhe tatime të ndershme, mbi një klimë të parashikueshme për biznesin dhe mbi një treg pune që hap dyer për të rinjtë. Ajo ngrihet mbi turizmin që nuk njihet më sezone, mbi bujqësinë dhe fshatin që modernizohen me teknologji, mbi energjinë e pastër që na kthen në eksportues të së ardhmes së gjelbër dhe mbi inovacionin që u jep hapësirë brezave të rinj për të krijuar e për të konkurruar. Dhe mbi të gjitha, ajo shtyhet përpara nga një infrastrukturë moderne – porte, aeroporte, hekurudha dhe korridore rrugore – që lidh Shqipërinë me rajonin, Evropën dhe botën, duke e bërë vendin tonë një nyjë të re zhvillimi.

Mirëqenia për të gjithë është shtylla e tretë dhe kontrata jonë me qytetarët. Ajo është kujdesi për fëmijët e vegjël që rriten në çerdhe e kopshte më të mira, është arsimi që lidhet me jetën reale dhe me Evropën, është shëndetësia falas e modernizuar, janë pensionet dinjitoze dhe shërbimet sociale që mbështesin ata që kanë nevojë. Është rinia që gjen punë dhe hapësira të reja, është sporti dhe kultura që gjallërojnë përditshmërinë, është mjedisi i mbrojtur dhe ekonomia e gjelbër që bëhen pjesë e zakoneve tona të përditshme.

Ky është programi ynë: Shqipëria evropiane, Shqipëria e rritjes dhe Shqipëria e mirëqenies, tri shtylla, një qëllim, një destinacion. Deri në vitin 2030, Shqipëria nuk do të trokasë më në derën e Evropës, sepse dera do të jetë e hapur, dhe ne do të jemi brenda, me dinjitet të plotë dhe me besimin e patundur se gjenerata jonë ka ditur t'i japë historisë shqiptare një fitore që nuk kthehet pas.

Shtylla I: Shqipëria evropiane

Shqipëria evropiane është misioni ynë kombëtar, ëndrra e brezave dhe detyra e gjeneratës sonë. Është busulla që i jep drejtim çdo vendimi dhe ritëm çdo reforme. Synimi është i qartë dhe i afërt: anëtarësimi i plotë në Bashkimin Evropian brenda vitit 2030. Ky nuk është thjesht një akt diplomatik, por një proces transformues që e bën shtetin shqiptar më të drejtë, ekonominë më konkurruese dhe shërbimet publike më afër qytetarit.

Shteti i së drejtës është themeli i Shqipërisë Evropiane. Teksa konsolidojmë pavarësinë e gjyqësorit, orientohejmë, përmes aleancës me teknologjinë, të kthejmë përfundimisht faqen e drejtësisë shqiptare drejt një sistemi eficient, pa tejzgjatje dhe me standardet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. Kodi i ri Penal dhe Kodi Civil do të jenë shtyllat e një legjislacioni modern të orientuar fuqimisht nga standardet evropiane.

Shteti digjital është fytyra moderne e qeverisjes. Shërbimet publike bëhen të thjeshta, të sigurta e të aksesueshme përmes *e-Albania* dhe asistentëve inteligjentë, të mbrojtura nga standard të sigurisë kibernetike që respekton standardet më të larta të BE-së. Çdo qytetar, në marrëdhënien e tij të përditshme me shtetin, duhet ta ndiejë Evropën në xhepin e tij dhe në telefonin e tij.

Administrata publike ngrihet mbi integritet, transparencë e reduktim të burokracive përmes injektimit të digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale në të gjitha proceset e punës. Lufta kundër korrupsionit nuk është vetëm betejë morale, por kusht i panegociueshëm i integritetit. Prokurimet modernizohen, rritet llogaridhënia dhe shteti bëhet gjithnjë e më shumë partner më i besueshëm i qytetarit dhe biznesit.

Siguria publike dhe rendi janë themeli mbi të cilin ndërtohet mirëqenia e qytetarëve dhe besimi te konsolidimi i imazhit të Shqipërisë si një vend i sigurt me qytete, fshatra dhe kufij të sigurt. Policimi modern, pajisur me teknologji, udhëhequr nga profesionalizmi dhe në bashkëpunim gjithnjë e më intensiv me partnerët evropianë e ndërkombëtarë, garanton rendin, parandalon krimin dhe vihet çdo ditë e më shumë në mbrojtje të të drejtave të çdo qytetari.

Siguria kombëtare dhe mbrojtja janë garancia e stabilitetit. Kapacitetet e emergjencave fuqizohen, forcat tona të armatosura modernizohen dhe ecin krah për krah me standardet e NATO-s. Një Shqipëri e fortë e bën më të fortë rajonin dhe e bën më të sigurt Evropën.

Politika e jashtme dhe diaspora janë ura jonë me botën. Diplomacia aktive e vendos Shqipërinë në qendër të dialogut dhe vendimmarrjes evropiane, ndërsa diaspora jonë e fuqizuar bëhet ambasadorja më e besueshme e vendit tonë, duke hapur dyer për investime, tregje dhe talente.

Rezultatet janë të matshme dhe të prekshme: deri në vitin 2027 përmbyllim negociatat, në vitin 2028 nënshkruajmë Traktatin e Anëtarësimit dhe në vitin 2030 Shqipëria hyn me dinjtet në familjen evropiane. Atë ditë, flamuri kuqezi do të valëvitet krenar mes flamujve të BE-së, jo si një vizitor i përkohshëm, por si pjesë e pandashme e saj.

Ky është realiteti që ne do të ndërtojmë. Ëndrra e brezave nuk do të mbetet më vetëm ëndërr, por do të bëhet e ardhmja e fëmijëve tanë. Shqipëria evropiane nuk është një horizont i largët – është stacioni ynë i afërt, është rruga jonë e përbashkët, është fitorja e gjeneratës sonë.

Shtylla II: Rritja ekonomike e qëndrueshme

Rritja ekonomike e qëndrueshme është boshti mbi të cilin ngrihet ky mandat qeverisës. Ajo nuk është thjesht një shifër në tabelat e ekonomisë, por është garancia që Shqipëria ecën përpara me financa të shëndosha, me sipërmarrje që inovon, me një treg pune më të drejtë dhe me një stabilitet makroekonomik që përkthehet në të ardhura më të larta dhe standard më të mirë jetese për çdo familje shqiptare. Rritja jonë është e lidhur me rregullat dhe disiplinën e Bashkimit Evropian, sepse vetëm kështu Shqipëria bëhet pjesë e plotë e ekonomisë së madhe evropiane.

Financat publike janë garancia e besimit dhe e qëndrueshmërisë. Ne synojmë një shtet që planifikon me përgjegjësi, shpenzon me mençuri dhe vepron me transparencë. Një arkitekturë fiskale e shëndoshë do të jetë ura mes rritjes dhe drejtësisë sociale: përmes barazisë tatimore, llogaridhënies dhe besimit mes shtetit dhe qytetarëve. Qëndrueshmëria fiskale nuk është thjesht disiplinë; është premtimi që gjeneratat që vijnë të gjejnë një ekonomi më të fortë se sot.

Bizneset janë zemra e rritjes ekonomike. Një klimë e qëndrueshme investimesh, mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe hapësira të reja për inovacion e sipërmarrje janë prioritetet tona. Shqipëria po bëhet vend ku procedurat burokratike zvogëlohen, ku sipërmarrësit kanë akses më të lehtë në financa, ku konkurrenca është e ndershme dhe ku biznesi i ndershëm shpërblehet.

Tregu i punës është pasqyra e shëndetit të ekonomisë. Me garancinë rinore, të rinjtë hyjnë me më shumë mundësi në punë; arsimi dual lidh edukimin me jetën reale dhe biznesin; ndërkohë që politikat aktive të punësimit nxisin punë të denja dhe të mirëpaguara. Një ekonomi e qëndrueshme nuk matet vetëm nga rritja e PBB-së, por nga aftësia për të hapur vende pune të sigurt dhe për të rritur cilësinë e jetës së punonjësve.

Infrastruktura moderne është motori i zhvillimit. Portet, aeroportet dhe rrjetet rrugore lidhin tregjet, hapin korridore të reja tregtare dhe i japin Shqipërisë një lëvizshmëri të re. Ky investim krijon jo vetëm punë, por edhe rrit besimin e investitorëve se Shqipëria është një vend që ofron stabilitet, akses dhe perspektivë.

Energjia e së ardhmes është e pastër, e sigurt dhe e përballueshme. Vizioni ynë është të kthejmë potencialin energjetik të Shqipërisë në avantazh kombëtar: për një industri konkurruese dhe për një vend që bëhet pjesë aktive e tranzicionit të gjelbër evropian. Energjia e gjelbër për ne është ekonomi, mjedis dhe siguri në të njëjtën kohë.

Inovacioni dhe teknologjia janë pasaporta e brezit të ri drejt botës. Shqipëria e vitit 2030 është një ekonomi që mendon dhe vepron digjitalisht. Ne synojmë një shoqëri ku inovacioni është kulturë pune, ku teknologjia përmirëson shërbimet publike, ku *startup*-et kthehen në biznese konkurruese dhe ku inteligjenca artificiale shfrytëzohet me përgjegjësi për të rritur cilësinë e jetës. Vendi ynë do të jetë një hapësirë ku idetë lindin, rriten dhe depërtojnë në tregun evropian.

Turizmi është vitrinë dhe motor i ekonomisë sonë. Ne shohim një Shqipëri që pret vizitorë gjatë gjithë vitit, me standarde të larta mikpritjeje, me identitet të fortë kulturor dhe me natyrë të mbrojtur. Me investime në infrastrukturë turistike, me diversifikim të ofertës, nga turizmi bregdetar tek ai kulturor, malor, shëndetësor e sportiv – vendi ynë kthehet në një histori suksesi ndërkombëtar. Turizmi nuk është vetëm ekonomi, është histori, kulturë dhe vlerë e shtuar kombëtare.

Bujqësia dhe zhvillimi rural janë themeli i qëndrueshmërisë. Me teknologji moderne, zinxhirë të integruar prodhimi dhe akses më të madh në tregjet evropiane, bujqësia shqiptare do të garantojë siguri ushqimore, do të mbështesë eksportet dhe do të lidhet drejtpërdrejt me turizmin. Zhvillimi rural do të thotë më shumë mundësi për fermerët, fshatra më të gjallë, ekonomi lokale më të forta dhe një territor të balancuar mes qytetit dhe fshatit.

Shqipëria e vitit 2030 është pjesë e plotë e Bashkimit Evropian, me një ekonomi të hapur dhe konkurruese që ecën në një hap me vendet më të zhvilluara të kontinentit. Është një ekonomi e gjelbër dhe moderne, që i kthen çdo pikë rritjeje në më shumë mundësi, më shumë punë të mirëpaguara dhe më shumë mirëqenie të prekshme për qytetarët. Rritja ekonomike nuk është vetëm objektiv – ajo është rruga për një Shqipëri të fortë, të qëndrueshme dhe evropiane.

Shtylla III: Mirëqenie për të gjithë

Mirëqenia është kontrata jonë me qytetarët – jo privilegj për pakicën, por e drejtë për çdo shqiptar. Ky është vizioni i Shqipërisë 2030: një vend me fytyrë njerëzore, me barazi shansesh dhe institucione që punojnë për qytetarin.

Fëmijët dhe të rinjtë janë boshti i politikave tona. Nga çerdhja dhe kopshti tek shkolla që përqafon teknologjinë dhe inteligjencën artificiale, nga arsimi profesional i lidhur me ekonominë reale tek universitetet me programe ndërkombëtare – ne garantojmë një sistem arsimor që i përgatit për të ardhmen.

Familja është zemra e shoqërisë. Një shtet social e modern duhet të sigurojë strehim të përballueshëm, mbështetje për prindërit e rinj, kujdes për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbime sociale komunitare të afërta e cilësore.

Shëndetësia publike është themel i mirëqenies. Ajo nis falas te mjeku i familjes, mbështetet në spitale të modernizuara dhe funksionon me dosje e receta elektronike, duke u garantuar qytetarëve kujdes shëndetësor cilësor, të barabartë dhe dinjitoz.

Pensionet janë garancia e shtetit për dinjitetin e brezit që ka ndërtuar vendin. Ne do të sigurojmë që çdo pensionist të ketë jo vetëm një mbështetje të drejtë financiare, por edhe akses në shërbime shëndetësore, sociale dhe komunitare që e bëjnë jetën më të sigurt dhe më të plotë.

Rinia është energjia e ndryshimit. Për të rinjtë, kalimi nga shkolla në punë duhet të jetë i lehtë; *start-up*-et inovative dhe sipërmarrja e re duhet të mbështeten; sporti dhe kultura duhet të jenë pjesë e përditshmërisë. Sepse rinia është gjeneratori i progresit, i krijimtërisë dhe i besimit tek e ardhmja.

Sporti dhe kultura nuk janë luks, por oksigjeni i përditshëm i shoqërisë. Ato gjallërojnë komunitetet, forcojnë identitetin tonë, rrisin shëndetin dhe krijojnë mundësi të reja për të rinjtë. Çdo qytet duhet të ketë hapësira sportive dhe kulturore të hapura, të aksesueshme, që na lidhin e na frymëzojnë si shoqëri.

Mjedisi dhe ekonomia e gjelbër janë garancia e zhvillimit të qëndrueshëm. Shqipëria duhet të rritet pa e shkatërruar natyrën. Riciklimi, hapësirat e gjelbra dhe menaxhimi modern i mbetjeve urbane do të bëhen pjesë e zakoneve të përditshme të qytetarëve dhe politikave publike.

Bashkitë janë krah i shtetit që sjellin shërbimin te dera e qytetarit. Me digjitalizim, financa të forta dhe administratë të motivuar me paga dinjitoze, ato do të sigurojnë shërbime publike cilësore, qendra urbane moderne dhe një portë të hapur për zhvillim.

SHQIPËRIA EVROPIANE

1.1 Anëtarësimi në Bashkimin Evropian

a) Çfarë arritëm së bashku

Me votën plebishitare të 11 majit shqiptarët na besuan bujarisht përgjegjësinë e madhe për të përshpejtuar, pa kthim mbrapa, rrugëtimin e Shqipërisë si anëtare e Bashkimit Evropian brenda vitit 2030, si mundësia jonë unike dhe e papërsëritshme për të shënuar pikën e kthesës në historinë e Shqipërisë.

Me anëtarësimin në BE, pasaporta shqiptare do të mbajë simbolin e Bashkimit Evropian, për të garantuar lëvizje të lirë pa radhë e pa kontrolle, ndërsa qytetarët tanë do të gëzojnë status e të drejta të barabarta në të gjithë Bashkimin Evropian, me mundësi të njëjta jetese, punësimi, investimi dhe edukimi. Ndaj do të punojmë deri që finalizimin e këtij rrugëtimi ta meritojmë deri në fund -që Shqipëria të mos trokasë, por të hyjë dhe të ulet denjësisht në tryezën e të barabartëve evropianë, brenda kësaj dekade.

Ngritur mbi themelet e reformës së thellë në drejtësi, vendosjes së besimit në funksionimin e institucioneve që luftojnë krimin e organizuar e korrupsionin, kthimin e Shqipërisë në një partner të besueshëm me të gjitha organizatat partnere dhe ato ndërkombëtare në garantimin e sigurisë së përbashkët, përqendrohemi tashmë te konsolidimi dhe modernizimin si pikëprerje për të gjitha reformat që e bëjnë Shqipërinë të anëtarësohet me dinjitet në Familjen e Madhe të Evropës së Bashkuar.

Sot jemi më afër se kurrë kësaj ëndrre sa të vjetër dhe aktuale edhe në saje të përqafimit të inovacionit në çdo hap të qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve dhe biznesit, kemi shndërruar Shqipërinë në një nga vendet më të avancuar në rajon për qeverisjen digjitale dhe vënien e inteligjencës artificiale në funksion të procesit të negociatave, luftës kundër korrupsionit, si themele të një administrate që sheh vetëm përpara drejt finishit të anëtarësimit.

b) Destinacioni ynë evropian

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian brenda vitit 2030. Anëtarësimi i Shqipërisë në BE është prioriteti mbi prioritetet e kësaj dekade – busulla që drejton çdo vendim strategjik. Është misioni kombëtar që riformaton në themel shtetin: institucione më të forta, shërbime më cilësore, ekonomi më konkurruese. Si pjesë e familjes evropiane, çlirojmë potencialin e plotë zhvillimor me të njëjtat standarde dhe akses të gjerë në politikat e instrumentet e BE-së.

c) Punët tona përpara

- Përmbysim negociatat e anëtarësimit deri në vitin 2027, duke hapur dhe mbyllur të gjithë kapitujt e *acquis*.

- Nënshkruajmë Traktatin e Anëtarësimit në BE deri në vitin 2028 dhe mundësojmë ratifikimin në parlamentet kombëtare të vendeve anëtare.

- Anëtarësohemi plotësisht në BE brenda vitit 2030, duke siguruar akses të barabartë për qytetarët dhe bizneset në tregun e përbashkët.

- Harmonizojmë plotësisht legjislacionin dhe politikat publike me *acquis communautaire*, duke përdorur për herë të parë në procesin e integritit inteligjencën artificiale për ta ulur kohën e transpozimit nga 7 në vetëm 2 vjet.

- Rrisim përthithjen e fondeve të BE-së në 1.25 miliardë euro deri në vitin 2030, përmes instrumenteve si RGF dhe IPA III.

- Rrisim praninë e Shqipërisë në institucionet e BE-së, si anëtarë ose vëzhgues, duke integruar ekspertët tanë në strukturat vendimmarrëse evropiane.

- Forcojmë kapacitetet e administratës publike me trajnim dhe struktura të posaçme për negociatat, duke përgatitur vendin për zbatimin e fondeve strukturore pas anëtarësimit.

- Konsolidojmë partneritetet strategjike dypalëshe me vendet anëtare për mbështetje politike dhe teknike të anëtarësimit.

- Rrisim ndërgjegjësimin publik për përfitimet e anëtarësimit dhe përgatisim qytetarët e bizneset për akses të plotë në tregun e përbashkët evropian.

1.2 Shteti digjital dhe siguria kibernetike

a) Çfarë arritëm së bashku

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka kaluar nga një administratë e ngadaltë me sportele fizike, në një shtet digjital ku 95% e shërbimeve publike ofrohen *online* përmes platformës *e-Albania*. Nga vetëm 14 shërbime digjitale në vitin 2014, sot qytetarët dhe bizneset kanë akses në 1,250 shërbime publike. Digjitalizimi ka kursyer 620 milionë euro dhe mbi 1,100 vjet pritje radhëve për qytetarët dhe bizneset.

Falë revolucionit digjital të kësaj dekade, shumë shërbime merren me një klikim, e të tjerat pa nevojën e ngarkimit të dokumenteve shtesë nga qytetarët e bizneset, duke eliminuar radhët, por edhe duke shpëputur njëherë e mirë zinxhirin korruptiv në sportele. Sot, Diella, asistentja digjitale e zhvilluar përmes inteligjencës artificiale jo vetëm orienton çdo qytetar për të marrë shërbime publike në kohë të shpejtë vetëm përmes një komande zanore, por ofron edhe 54 dokumente me vulë elektronike.

Shqipëria është vendi i vetëm në rajon që po përdor inteligjencën artificiale për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke automatizuar përkthimin dhe përafrimin e legjislacionit me *acquis* e BE-së, duke lehtësuar punën e institucioneve dhe duke e vendosur vendin tonë në pararojë të integritetit evropian.

Në sajë të një vëmendjeje të posaçme për ruajtjen e integritetit të sistemeve tona, sot Shqipëria është ndër vendet e para në rajon që ofron mbrojtje proaktive kibernetike, duke i bërë ballë me shumë profesionalizëm të gjitha sulmeve të sofistikuara të përditshme, nga aktorë keqdashës.

b) Destinacioni ynë evropian

Shqipëria 2030 përqafon digjitalizimin dhe inovacionin në çdo hallkë të qeverisjes dhe konsolidon një ekosistem kombëtar të sigurisë kibernetike, të certifikuar sipas standardeve të BE-së.

Shërbime publike të thjeshta, të sigurta dhe të aksesueshme nga telefoni apo kompjuteri për çdo qytetar dhe biznes. Sistemet tona komunikojnë drejtpërdrejt me platformat e BE-së, që qytetarët shqiptarë të përfitojnë të njëjtat shërbime si në tregun e vetëm digjital. Zbatojmë plotësisht legjislacionin e ri të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale, duke rritur besimin e qytetarëve dhe investitorëve. Garantojmë zhvillimin e inteligjencës artificiale në përputhje me EU AI Act, duke siguruar përdorim të sigurt, etik dhe transparent. Inovacioni me inteligjencë artificiale, infrastruktura e avancuar teknologjike dhe platformat e të dhënave të hapura do të jenë motori i këtij transformimi drejt integritetit evropian.

c) Punët tona përpara

- Përfundojmë transformimin e *e-Albania 2.0* sipas modelit “*life events*”, duke ofruar shërbime proaktive ku shteti shkon te qytetari dhe të personalizuar sipas rrethanave të jetës.

- Shndërrojmë Diellën në asistenten personale të çdo qytetari dhe biznesi, duke e udhëhequr hap pas hapi në marrjen e shërbimeve elektronike dhe në plotësimin e aplikimeve në *e-Albania*.

- Digjitalizojmë të gjitha shërbimet publike në nivel vendor për t’i ofruar në *e-Albania*, sipas modelit të shërbimeve publike në nivel qendror.

- Krijojmë një sistem tërësisht të automatizuar të prokurimeve publike me Inteligjencë Artificiale, të ndërveprueshëm edhe me sistemet e Bashkimit Evropian, duke eliminuar korrupsionin, abuzimet dhe ndërhyrjen njerëzore.

- Krijojmë Dosjen Elektronike Shëndetësore për çdo qytetar, sipas standardeve të BE-së, për shërbim shëndetësor më cilësor dhe më të aksesueshëm.

- Përdorim inteligjencën artificiale në radiologji, për të analizuar imazhet mjekësore në mënyrë të automatizuar, duke ndihmuar mjekët të identifikojnë me shpejtësi dhe saktësi diagnozat (si kanceret

në faza të hershme, anomalitë pulmonare apo sëmundjet kardiale), duke ulur normën e gabimeve dhe duke rritur cilësinë e shërbimit shëndetësor.

- Zbatojmë Inteligjencën Artificiale në sistemet tatimore dhe doganore për të identifikuar në kohë reale anomalitë, duke rritur transparencën, ulur evazionin dhe përshpejtuar procedurat për qytetarët dhe bizneset.

- Vendosim Inteligjencën Artificiale në qendër të emergjencave civile kombëtare, duke identifikuar në kohë reale rreziqet (zjarre, tërmete, trafik ajror, trafik tokësor etj.).

- Vëmë në funksion Portofolin e Identitetit Digjital, me dokumente identifikimi të vlefshme në të gjithë BE-në nga viti 2027.

- Kthejmë Platformën e Bashkëqeverisjes nga një mekanizëm ndërveprimi në një sistem inteligjent, të fuqizuar nga AI, që analizon automatikisht ankesat, sugjeron zgjidhje ligjore dhe gjeneron rekomandime për reforma – një model në përputhje të plotë me standardet e BE-së për qeverisjen digjitale.

- Përdorim inteligjencën artificiale mbi të dhënat bujqësore, meteorologjike dhe satelitore, për të krijuar sisteme parashikuese mbi prodhimin dhe cilësinë e të korrave, duke ulur rrezikun nga përmbytjet, thatësirat apo fatkeqësi të tjera natyrore dhe duke garantuar sigurinë ushqimore afatgjatë.

- *Implementojmë European Case Law Identifier (ECLI)* në Shqipëri, duke i dhënë çdo vendimi gjyqësor një identifikues unik dhe të krahasueshëm jurisprudencën evropiane.

- Hapim epokën e re të shërbimeve konsullore me apostilim elektronik të dokumenteve, në të gjithë hapësirën evropiane, sipas parimit “*Once Only*”.

- Krijojmë AI Factory si motorin kombëtar të inteligjencës artificiale për krijimin e zgjidhjeve inovative në administratën publike, në ekonomi dhe në shoqëri.

- Vijojmë nismën “*Government AI Campus*”, për ndërtimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë në përdorimin etik dhe efektiv të AI, nga shëndetësia deri tek arsimi dhe shërbimet ndaj qytetarëve.

- Ngremë Qendrën Kombëtare të Përpunimit të Lartë (HPC) për analizë të avancuar të të dhënave dhe trajnime të modeleve të inteligjencës artificiale në dispozicion të qeverisë, akademisë dhe sipërmarrjeve, duke vendosur në zemër të zhvillimit kombëtar fuqinë e teknologjisë.

- Shndërrojmë Portalin e të Dhënave të Hapura në një platformë transparence dhe inovacioni, duke e pozicionuar Shqipërinë si qendër rajonale të ekonomisë së të dhënave.

- Transformojmë qendrat ADISA në Qendra Rinore të Inovacionit, duke nxitur e zhvilluar aftësi të avancuara digjitale të të rinjve.

- Shtrijmë rrjetin e *Smart Labs* në të gjitha shkollat, duke ofruar bazën teknologjike për përdorimin e AI për mësim të personalizuar dhe simulime edukative, në përputhje me standardet e BE-së për laboratorë inovativë në arsim.

- Nisim projektin kombëtar për *Smart City*, duke e kthyer çdo qytet në një organizëm inteligjent, ku të dhënat mbledhen dhe analizohen në kohë reale për trafikun, sigurinë, energjinë dhe emergjencat. Qyteti do të bëhet një hapësirë ku teknologjia u paraprin nevojave të përditshme të qytetarëve.

- Shtrijmë *GovNet Broadband* në të gjithë vendin duke garantuar lidhje të sigurt mes sistemeve qeveritare në mbarë territorin dhe ngremë Qendrën e Vazhdueshmërisë dhe Rimëkëmbjes së Punës (*Business Continuity and Data Recovery Center - BCC/DRC*) për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve në 99.9% të kohës.

- Forcojmë mbrojtjen kibernetike kombëtare përmes përdorimit të platformave të avancuara të monitorimit të *dark web*-it dhe inteligjencës së kërcënimeve, duke e shndërruar Qendrën Qeveritare Operacionale të Sigurisë në një Qendër të Inovacionit për Sigurinë Kibernetike.

1.3 Administrata publike, antikorrupsioni dhe transparenca

a) Çfarë arritëm së bashku

Në harkun e dhjetë vjetëve, Shqipëria ka kaluar nga një administratë e ngadaltë, me sportele të mbingarkuara dhe shërbime të centralizuara, në një administratë moderne, digjitale dhe me integritet. Sot, mbi 95% e shërbimeve publike ofrohen *online* përmes platformës *e-Albania*, duke kursyer kohë, para dhe duke eliminuar kontaktin fizik që ushqente korrupsionin e vogël.

Jo vetëm shërbimet publike, por edhe njerëzit pas tyre kanë qenë në qendër të reformës, pasi çdo punonjës publik është fytyra e shtetit para qytetarit dhe meriton trajtim me dinjitet për kontributin e përditshëm. Paga mesatare në administratë është rritur nga 530 euro në vitin 2013 në 1.050 euro në vitin 2025 - një hap historik që jo vetëm i jep vlerën e duhur shërbimit publik, por edhe e bën shtetin më të fortë në shërbim të qytetarëve. Raporti i Monitorimit të SIGMA 2024 ka renditur Shqipërinë ndër vendet më të avancuara në rajon për menaxhimin e financave publike, burimeve njerëzore dhe politikave të reformës në administratë.

Në fushën e luftës kundër korrupsionit, reformat e thella në drejtësi dhe digjitalizimi i shërbimeve kanë ndikuar rrënjësisht në prerjen e zinxhirëve korruptivë. Paralelisht, prokurimi publik ka kaluar një transformim të plotë me sisteme elektronike, duke rritur transparencën dhe duke ulur abuzimet, si dhe duke kursyer progresivisht gjithnjë e më shumë të ardhura nga buxheti i shtetit.

b) Destinacioni ynë evropian

Ndërtimi i një shteti “të zgjuar”, transparent dhe me integritet, si motor i procesit të anëtarësimit në BE.

Kjo do të thotë administratë pa burokraci të panevojshme dhe me përdorim të avancuar të inteligjencës artificiale në të gjitha proceset e punës dhe e aftë të parashikojë nevojat e qytetarëve dhe biznesit. Lufta kundër korrupsionit do të ngrihet në një nivel të ri, duke e bërë integritetin dhe transparencën busull të çdo vendimmarrjeje dhe duke përqendruar vëmendjen në sektorët me risk të lartë korrupsioni.

c) Punët tona përpara

- Kalojmë drejt një administrate “pa letër”, duke reduktuar ndjeshëm përdorimin e dokumentacionit fizik dhe duke avancuar digjitalizimin e plotë të komunikimit ndërinstitucional dhe me qytetarët.

- Transformojmë Sistemin e Burimeve Njerëzore përmes digjitalizimit tërësor të proceseve dhe inteligjencës artificiale, duke automatizuar pagat, vlerësimin e performancës dhe parashikimin e nevojave për zhvillim kapacitetesh.

- Thellojmë reformën në shërbimin civil për të garantuar rekrutime transparente dhe meritokratike, përmes një portali unik rekrutimi dhe një asistenti digjital 24/7 për aplikimet.

- Përqendrohemi te parandalimi i korrupsionit, përmes ngritjes së një sistemi të identifikimit, vlerësimit dhe minimizimit të rreziqeve të korrupsionit në prona, tatime, dogana, shëndetësi, arsim, prokurime dhe kontrata publike.

- Shndërrojmë platformën “*Transparent Albania*” në portën unike më të besuar të transparencës mbi shpenzimet dhe projektet publike, duke vënë në përdorim inteligjencën artificiale për të gjurmuar automatikisht të dhënat publike, monitoruar proceset dhe forcuar llogaridhënien.

- Zbatojmë prokurimin *Smart*, një nga sistemet e para në Evropë me motor të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara.

1.4 Drejtësia dhe të drejtat themelore

a) Çfarë arritëm së bashku

Reforma në Drejtësi është transformimi më i madh institucional në historinë e shtetit shqiptar, i nisur nga qeveria shqiptare me mbështetjen e partnerëve evropianë dhe amerikanë duke u shndërruar në “kalin e betejës” së Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në BE. Për herë të parë në historinë e Shqipërisë pluraliste, produkte të kësaj reforme në drejtësi janë institucione të cilat dita-ditës rifitojnë besimin e qytetarëve në luftën ndaj pandëshkueshmërisë. Në këtë fazë kritike të negociatave, vëmendja

përqendrohet në forcimin e një drejtësie të pavarur dhe eficiente të bazuar mbi standarde, që përqafon inovacionin dhe u përgjigjet me përpikëri detyrimeve që burojnë nga piketat e ndërmjetme dhe Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës në kuadër të anëtarësimit në BE. Kodi i ri Penal është në fazë të avancuar: një qasje moderne që pasqyron zhvillimet shoqërore, mbron më fort viktimat, vendos sanksione proporcionale dhe garanton përputhje të plotë me *acquis* të BE-së në fushën penale në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Paralelisht, po harmonizojmë legjislacionin civil me këto standarde nëpërmjet një Kodi të ri Civil.

Falë përpjekjeve të shumëfishta me partnerët është mundësuar financimi i plotë i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore me mbështetjen e BE-së dhe Suedisë, duke hapur rrugën për përdorimin e inteligjencës artificiale në drejtësi.

Investimet në institucionet penitenciare, si dhe miratimi i Masterplanit të Burgjeve, kanë qenë baza për forcimin e kapaciteteve të këtij sistemi, në funksion të garantimit të të drejtave të personave që vuajnë dënimet me burgim.

b) Destinacioni ynë evropian

Konsolidimi i një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm, efikas dhe të aksesueshëm për çdo qytetar, sipas standardeve evropiane që mbron të drejtat dhe liritë themelore.

- Anëtarësimi në BE kërkon një shtet funksional ku sundimi i ligjit është themel, ndaj mbështetja ndaj drejtësisë është prova më e fortë e seriozitetit të Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian. Duke u ngritur mbi arritjet e deritanishme, do të kontribuojmë në drejtësi që garanton standarde, respekton të drejtat themelore të njeriut dhe lufton pa kompromis kriminalitetin. Digjitalizimi i shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike do të jetë hapi cilësor në funksion të rritjes së eficiencës dhe shpejtësisë së ofrimit të shërbimeve gjyqësore për qytetarët që do ta bëjnë sistemin më transparent, më të shpejtë dhe më afër qytetarëve.

c) Punët tona përpara

- Fuqizojmë standardet e reformës në drejtësi, duke rishikuar legjislacionin sipas detyrimeve të ndërmarra në kuadër të negociatave me BE-në.

- Miratojmë Kodin e ri Penal dhe Kodin e ri Civil, të përafëruar me standardet e BE-së.

- Funksionalizojmë Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë deri në vitin 2028, duke përfshirë module të inteligjencës artificiale për menaxhimin e çështjeve.

- Modernizojmë infrastrukturën gjyqësore, me ndërtimin dhe rikonstruksionin e gjykatave e prokurorive sipas standardeve më të mira në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve ofruar qytetarëve.

- Zbatojmë Masterplanin e Burgjeve dhe përmirësojmë kushtet e të paraburgosurve dhe të dënuarve, duke reduktuar recidivizmin.

- Hapim Institutin për Edukimin dhe Rehabilitimin e të Miturve, duke ndërtuar një sistem të drejtësisë penale për të mitur sipas standardeve evropiane.

1.5 Politika e jashtme dhe diaspora

a) Çfarë arritëm së bashku

Politika e jashtme e Shqipërisë gjatë dekadës së fundit është ndërtuar mbi parimin e një aleance të patjetërsueshme me SHBA-në dhe Bashkimin Evropian, si dhe mbi angazhimin aktiv në NATO dhe organizatat ndërkombëtare. Shqipëria ka forcuar profilin e saj global duke kryesuar OSBE-në, shërbyer si anëtare e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe duke marrë role kyçe në UN Women, UNESCO dhe Këshillin e të Drejtave të Njeriut.

Shqipëria ka ndërtuar gradualisht një diplomaci aktive dhe zhvillimore, e cila i ka shërbyer integritetit evropian, forcimit të stabilitetit rajonal dhe avancimit të interesave kombëtare. Pjesëmarrja në nisma rajonale dhe organizimi i Samitit të Komunitetit Politik Evropian (2025) dhe Samitit të NATO-s

(2027) në Tiranë e kanë pozicionuar vendin si një faktor kyç stabiliteti dhe një promotor të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Përmes marrëveshjeve strategjike me Italinë, SHBA, Francën, Kroacinë, Turqinë dhe Mbretërinë e Bashkuar, kemi rritur dita-ditës rolin e diplomacisë ekonomike për rritjen e ndjeshme të investimeve të huaja në Shqipëri dhe eksportet shqiptare jashtë vendit. Paralelisht, shërbimi konsullor është modernizuar me digjitalizim, hapjen e 52 shërbimeve *online* për diasporën dhe njohjen e patentave shqiptare në 11 shtete.

b) Destinacioni ynë evropian

Përmes diplomacisë aktive, Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian brenda vitit 2030 dhe të konsolidojë pozicionin e saj si faktor stabiliteti e besueshmërie në rajon dhe botë.

Diplomacia do të orientohet drejt mbrojtjes së interesave kombëtare, zgjerimit të marrëdhënieve strategjike dypalëshe, pjesëmarrjes në politikën e jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së dhe promovimit të diasporës shqiptare si një forcë zhvillimi. Përdorimi i inovacionit edhe në politikën e jashtme do të forcojë analizën strategjike, ndërsa diplomacia digjitale do ta bëjë Shqipërinë më të pranishme dhe më konkurruese në arenën globale.

c) Punët tona përpara

- Thellojmë partneritetet strategjike dypalëshe me SHBA-në dhe vendet e BE-së për të përshpejtuar anëtarësimin e Shqipërisë në BE deri më 2030; konsolidojmë partneritetin me Turqinë dhe Mbretërinë e Bashkuar në energji, siguri, teknologji dhe bujqësi.

- Organizojmë me sukses Samitin e NATO-s në Tiranë (2027) dhe forcojmë profilin rajonal të Shqipërisë si garant i stabilitetit.

- Zgjerojmë rrjetin diplomatik me të paktën 10 përfaqësi të reja deri më 2029-n dhe konsolidojmë rolin e atashëve ekonomikë.

- Ngremë një “*One-Stop Shop*” për investorët e huaj.

- Dyfishojmë investimet e huaja direkte dhe rrisim eksportet me mbi 10% mesatarisht në vit, përmes diplomacisë ekonomike.

- Promovojmë identitetin shqiptar në arenën ndërkombëtare përmes diplomacisë kulturore dhe shkencore, duke forcuar imazhin e Shqipërisë si vend evropian dhe modern.

1.6 Mbrojtja dhe siguria kombëtare

a) Çfarë arritëm së bashku

Nga një sektor i nënfinancuar, në dekadën e kaluar, mbrojtja është kthyer në një shtyllë të sigurisë kombëtare dhe instrument i kontributit të Shqipërisë në sigurinë rajonale. Investimet janë rritur nga 28 milionë euro në mbi 280 milionë euro, dhe buxheti i mbrojtjes në tërësi ka kaluar për herë të parë mbi 2% të PBB-së. Modernizimi i Forcave të Armatosura është bërë realitet me pajisjen e flotës ajrore me helikopterët *Black Hawk*, krijimin e Komandës kibernetike, vendosjen në funksion të dronëve *Bayraktar* dhe inaugurimin e Bazës Ajrore Taktike të NATO-s në Kuçovë.

Kërcënimet hibride të dekadës së tretë të shekullit XXI dhe epoka e paparashikueshmërisë së ushtrimit të forcës diktojnë nevojën që mbrojtja të qëndrojë në ballë të përparësive tona, nën udhëheqjen e interesave kombëtare, integritetit të vendit në BE dhe përgjegjësisë tona brenda NATO-s. Në këtë kontekst, organizimi i Samitit të NATO-s në Shqipëri në vitin 2027, përbën një gur kilometrik.

b) Destinacioni ynë evropian

Programi “Mbrojtja 2030” siguron më shumë burime financiare për mbrojtjen, përmes një rritjeje vjetore të buxhetit me jo më pak se 0.15 pikë mbi normën aktuale prej 2,01% të PBB-së, si dhe duke mobilizuar të ardhurat nga industria ushtarake dhe miradministrimi i aseteve. Kjo përpjekje financiare kombëtare është parakushti për realizimin e vizionit tonë për një Shqipëri të sigurt dhe strukturalisht

të qëndrueshme në kapacitetet e saj mbrojtëse, reaguese dhe prodhuese, mbështetur në pesë shtylla veprimi:

c) Punët tona përpara

- Shtojmë dhe forcojmë burimet njerëzore të Forcave të Armatosura, si një rezervë kombëtare e kapitalit njerëzor, duke vendosur në qendër aftësitë dhe etikën luftarake, ekselencën akademike, disiplinën, kulturën e gjithanshme, vetëdijen historike dhe patriotizmin. Paga e ushtarakëve, aktualisht më e larta në rajon, do vijojë të rritet dhe do të arrijë mesataren e NATO-s në vitin 2029.

- Zhvillojmë industrinë ushtarake “*Made in Albania*” për prodhimin e municioneve, armatimit të lehtë, mjeteve të blinduara, mjeteve të emergjencave civile dhe sistemeve pa pilot, duke e shndërruar vendin në një qendër rajonale të industrisë së mbrojtjes. Zgjerojmë, gjithashtu, kapacitetet detare me tri anije të reja dhe modernizojmë flotën ekzistuese.

- Modernizojmë dhe zhvillojmë infrastrukturën kritike duke përmbyllur brenda vitit 2029: investimet në Korridorin VIII për mobilitetin e Aleancës, me pikënisje në Porto-Romano; kantierin e Spitalit të Traumës; Shkollën e Aviacionit në Vlorë; Kampusin e Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura; Kompleksin e Inovacionit Ushtarak në Bërzhitë dhe Poligonin Ndërkombëtar në Bizë. Vijojmë, gjithashtu, programin kombëtar të infrastrukturës parandaluese duke rikualifikuar ura, diga dhe prita lumore.

- Fuqizojmë mbrojtjen civile duke investuar në dy avionë zjarrfikës, flotë të përforcuar tokësore dhe katër qendra të reja rajonale të emergjencave civile. Forcojmë aftësitë reaguese në territor me zgjidhje inovative, sisteme inteligjente dhe jetësimin e numrit kombëtar/ndërkombëtar 112.

- Digjitalizojmë mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare: duke nisur nga mbrojtja kibernetike, kapacitetet antidron, sistemet e komandim kontrollit dhe deri te sistemet satelitore, inovacioni do të jetë në qendër të investimeve modernizuese në të gjithë spektrin e aktivitetit ushtarak dhe civil, në veçanti, për sa i përket përsosjes së inteligjencës ushtarake, mbrojtjes civile dhe sistemeve të luftimit.

1.7 Siguria publike

a) Çfarë arritëm së bashku

Në më shumë se një dekadë, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit kanë kaluar një proces të thellë transformimi, duke vendosur në qendër të politikave sigurinë publike, modernizimin institucional e bashkëpunimin ndërkombëtar. Rezultatet dëshmojnë ndryshim të prekshëm për jetën e qytetarëve, në perceptimin e tyre për sigurinë dhe në pozicionimin e Shqipërisë si një partner i besueshëm në arenën evropiane e globale.

Përmes krijimit të zonave policore dhe afrimit të shërbimeve me komunitetin, sot, 82% e qytetarëve ndihen të sigurt në lagjen e tyre, nga vetëm 63% në vitin 2013. Krimet ndaj personit kanë njohur një ulje historike, gati tri herë më pak, ndërsa fatalitetet nga aksidentet rrugore kanë, krahasuar me 2013-n, vitin e fundit janë 120 jetë të shpëtuar më shumë.

Shqipëria është vendi i parë jashtë BE-së, ku nisën operacionet e përbashkëta me FRONTEX, të cilat u zgjeruan në rajon. Qindra operacione të përbashkëta me partnerët, shkëmbime informacioni përmes INTERPOL dhe EUROPOL, si dhe pjesëmarrja në rrjetin EN-FAST për kapjen e personave në kërkim, dëshmojnë besueshmërinë e autoriteteve tona lizgjzbatuese. U ngrit Zyra për Rikuperimin e Aseteve dhe u forcua po ashtu i gjithë procesi i administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, duke orientuar përdorimin e tyre për qëllime sociale.

Projekti “Çdo shqiptar një adresë” i dha fund kaosit mbi regjistrimin e vendbanimeve. Si dhe u krijua me sukses “IdentiTek” sh.a., për prodhimin e dokumenteve biometrike të standardeve më të larta për qytetarët, brenda e jashtë vendit.

b) Destinacioni ynë evropian

Shqipëria 2030, shtet i sigurt. Shfrytëzojmë inovacionin teknologjik për mbrojtjen e qytetarëve, rritim kontrollin e territorit dhe kufijve tanë, si dhe garantojmë reagim të shpejtë e në kohë ndaj emergjencave.

Në qendër të reformave është mbështetja e luftës kundër kriminalitetit, menaxhimi i integruar i kufijve dhe migracionit, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar përmes aplikimit të teknologjisë inteligjente. Parimi “Kufij të hapur, por të sigurt” dhe akreditimi sipas standardeve ISO udhëheqin modernizimin e shërbimeve policore. Përmes qasjes “*Smart City*” orientohe mi drejt parandalimit të paligshmërisë dhe reagimit të shpejtë.

c) Rezultate të pritshme

- Përafrojmë legjislacionin me të gjithë kuadrin e BE-së kundër krimit të organizuar, trafikimit, pastrimit të parave, terrorizmit dhe krimeve ndaj të miturve.

- Funksionalizojmë projektin “*Smart City*” si qendër operationale unike: rrjet i integruar kamerash/sensorësh, dronë dhe aplikacione ndërvepruese; ulet koha mesatare e reagimit policor në ≤7 minuta në 20 qytete deri më 2030-n;

- Rritim sigurinë rrugore: 30% më pak fatalitete deri më 2030-n përmes monitorimit inteligjent, edukimit dhe ndërhyrjeve infrastrukturore që shpëtojnë jetë;

- Kontrollojmë territorin me Hartën Digjitale të Kriminalitetit, përdorim sistematik i dronëve/satelitëve dhe sanksione efektive kundër informalitetit dhe ndërtimeve pa leje – nga sinjalizimi tek pezullimi e prishja, me gjurmueshmëri të plotë e pa subjektivizëm;

- Operacionalizojmë plotësisht Zyrën e Rikuperimit të Aseteve dhe kthejmë pasuritë kriminale në investime komunitare, si: shkolla, qendra rinore, hapësira publike;

- Modernizojmë identitetin digjital dhe dokumentet biometrike: pasaporta të reja me elemente sigurie të avancuar dhe *e-Tracking*; digjitalizojmë Arkivin e Gjendjes Civile dhe krijojmë regjistrë të unifikuar adresash (përfshirë diasporën);

- Menaxhojmë kufijtë dhe migracionin sipas standardeve të *Schengen*-it: model “Një ndalesë” në pikat kufitare; ndërtojmë plane kontigjence dhe ngremë Qendër të dedikuar për të Miturit e Huaj të Pashoqëruar;

- Forcojmë reagimin ndaj zjarreve: ngremë Qendrën e Përbashkët të Koordinimit për stacionet zjarrfikëse dhe Qendrën Kombëtare të Trajnimit, për veprime ndërinstitucionale në kohë reale, stërvitje sezonale dhe zbulim të hershëm të zjarreve me teknologji inteligjente.

SHTYLLA II

RRITJA EKONOMIKE E QËNDRUESHME

2.1 Financat publike dhe politika fiskale

a) Çfarë arritëm së bashku

Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të zhvillimit ekonomik, duke trefishuar potencialin e saj prodhues dhe duke e kthyer rritjen në mirëqenie të prekshme për qytetarët. Prodhimi i brendshëm bruto është rritur mbi 2.5 herë, nga 9.6 miliardë euro në vitin 2013 në mbi 25 miliardë euro sot, duke garantuar më shumë ekonomi aktive, më shumë vende pune dhe më shumë investime për të ardhmen.

Të ardhurat për frymë janë trefishuar, nga 3,324 euro në vitin 2013 në mbi 10,342 euro në vitin 2024, një dëshmi e qartë se zhvillimi ekonomik është shndërruar në përmirësim real të standardit të jetesës në çdo familje shqiptare, duke u rritur edhe më shpejt se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në tregun e punës, Shqipëria ka arritur rezultate historike: papunësia është ulur nga 17.5% në 8.8%, ndërsa papunësia rinore ka rënë nga 31.4% në 19.1%, duke krijuar më shumë mundësi për të rinjtë. Rritja e të ardhurave nga puna është po aq e dukshme: paga mesatare është rritur nga 322 euro në 830

euro, ndërsa paga minimale është më shumë se dyfishuar, nga 157 euro në 400 euro, duke fuqizuar të ardhurat e qytetarëve dhe përmirësuar jetesën e çdo familjeje.

Një tjetër arritje kyçe është konsolidimi fiskal: me gjithë përballjen me tri goditje tejet të forta (tërmeti, pandemia dhe kriza energjetike), borxhi publik është ulur ndjeshëm nga 70.3% e PBB-së në 54.2%, duke krijuar hapësira më të mëdha për investime strategjike dhe duke kursyer çdo vit rreth 300 milionë euro për buxhetin e shtetit. Në të njëjtën kohë, Shqipëria ka trefishuar eksportet e saj, duke i çuar nga 2.8 miliardë euro në vitin 2013 në 8.4 miliardë euro sot, duke e bërë ekonominë shqiptare më konkurruese dhe më të hapur ndaj tregjeve ndërkombëtare.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë është garantimi i stabilitetit makroekonomik, dhe ndërtimi i një sistemi të konsoliduar fiskal modern, transparent dhe në përputhje të plotë me standardet e Bashkimit Evropian.

c) Punët tona përpara

- Rrisim të ardhurat për frymë për qytetarët me rreth 40%, duke i çuar në 15.000 euro deri në vitin 2029;

- Viojmë me rritjen ekonomike me rreth 4% në vit duke e çuar prodhimin e brendshëm bruto në 35 miliardë euro deri në fund të mandatit;

- Viojmë me konsolidimin fiskal, duke reduktuar gradualisht deficitin buxhetor dhe duke ulur borxhin publik;

- Do të vijohet me rritjen e shpenzimeve të drejtpërdrejta të Qeverisë për mbrojtjen sociale për të garantuar dinjitet dhe mbështetje për të gjithë qytetarët në nevojë;

- Ruajmë stabilitetin e çmimeve dhe objektivin e inflacionit prej 3% të synuar nga Banka e Shqipërisë;

- Ruajmë stimul fiskal në ekonomi përmes mbajtjes së një niveli të qëndrueshëm investimesh rreth 5% të PBB-së;

- Rrisim të ardhurat tatimore me mbi 30 miliardë lekë në vit përmes zgjerimit të bazës tatimore pa rritur barrën fiskale, digjitalizimit të shërbimeve, si dhe vazhdimin e luftës ndaj informalitetit;

- Çelim një kapitull të ri bashkëpunimi me sipërmarrjen shqiptare përmes marrëveshjeve disavjeçare të lehtësimit tatimor dhe nxitjes së deklarimeve të rregullta duke zbatuar “Paqen fiskale” 2026–2029: faljen e detyrimeve tatimore më të vjetra se 10 vjet; skemën e ripagimit të borxheve të 10 vjetëve të fundit me përqindje të reduktuara;

- Viojmë me politikën e taksës 0% për bizneset e vogla deri në vitin 2029.

- Zbatojmë reformën e taksës mbi pasuritë e paluajtshme, duke kaluar në një sistem të ri të bazuar në vlerën reale të tregut përmes përditësimit të çmimeve, rivlerësimit masiv të pasurive dhe Kadastrës Fiskale.

- Rishikojmë skemën e TVSH-së për fermerët bazuar në praktikat më të mira të BE-së me një efekt financiar prej rreth 1.5 mld lekë/vit transfertë direkte te fermerët.

- Përafrim të plotë të legjislacionit tatimor/doganor me direktivat e BE-së, duke garantuar interoperabilitetin me vendet e Unionit.

- Krijojmë Këshillin Fiskal, si një institucion të pavarur për vlerësimin e qëndrueshmërisë së financave publike dhe respektimit të rregullave fiskale.

- Modernizojmë financat vendore.

- Përmirësojmë sistemin financiar të qeverisë.

2.2 Politikat për biznesin

a) Çfarë arritëm së bashku

Shqipëria ka bërë hapa të mëdhenj për të krijuar një klimë më të favorshme për sipërmarrjen, duke ulur barrën fiskale për bizneset e vogla, thjeshtuar procedurat dhe rritur konkurrueshmërinë e tregut vendës në raport me rajonin dhe Bashkimin Evropian.

Një nga masat më të rëndësishme ka qenë rritja e pragut të TVSH-së në nivelin më të lartë në rajon, duke përjashtuar shumicën e bizneseve të vogla nga kjo detyrë. Sot, vetëm 27% e bizneseve janë subjekt i TVSH-së, ndërsa pjesa tjetër përfitojnë nga politika lehtësuese që i ka liruar nga kjo barrë fiskale.

Gjithashtu, u ndërmor një reformë e thellë për tatimin mbi të ardhurat e bizneseve të vogla: u eliminua tatimi për bizneset me xhiro deri në 14 milionë lekë, duke përjashtuar 90% të bizneseve të vogla dhe duke u lënë sipërmarrësve në dispozicion rreth 17 miliardë lekë çdo vit për të investuar dhe zgjeruar aktivitetin e tyre.

Një tjetër hap strategjik ka qenë integrimi i Shqipërisë në SEPA (Zona e Pagesave të Vetme Evropiane), i cili ka ulur ndjeshëm kostot e pagesave ndërkombëtare, ka përshpejtuar transaksionet me tregjet e BE-së dhe ka lehtësuar qasjen e biznesit shqiptar në ekonominë evropiane.

Në të njëjtën kohë, është avancuar procesi i digjitalizimit të shërbimeve publike për biznesin, duke eliminuar burokracinë dhe duke mundësuar aplikime *online* për leje, licenca dhe dokumente. Kjo ka kursyer kohë dhe kosto për sipërmarrjen dhe ka reduktuar ndjeshëm hapësirat për korrupsion.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë është të ndërtojmë një ekonomi dinamike dhe konkurruese, ku bizneset shqiptare të përmbushin standardet e Bashkimit Evropian, të kenë akses të drejtë në financim dhe të jenë në gjendje të konkurrojnë denjësisht në tregun e përbashkët evropian.

c) Punët tona përpara

- Mobilizojmë mbi 2 mld € kredi dhe garanci për bizneset, përmes Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Shqiptare të Zhvillimit, për të rritur investimet dhe prodhimin vendës.

- Miratojmë dhe zbatojmë Strategjinë Kombëtare Industriale për transformimin ekonomik të Shqipërisë, duke vendosur bazat për një ekonomi më konkurruese dhe moderne, e duke orientuar politikën dhe fondet drejt sektorëve që gjenerojnë vlerë të shtuar.

- Me Paketën e Maleve, mundësojmë zhvillimin e investimeve në zonat malore, duke lehtësuar marrjen e lejes së ndërtimit për poseduesit që duan të investojnë, si dhe zgjidhim marrjen e dokumenteve për pronën e familjeve. Për 500 sipërmarrësit e parë përfitues, nga paketa, taksat do të jenë zero dhe TVSH-ja zero për 10 vjetët e parë.

- Ngremë “*Credit Bureaus*” për të ulur riskun e kreditimit.

- Heqim çmimet e referencës për importet nga BE-ja, për ulje kostosh dhe lehtësim tregtie.

- Nxsisim investimet me rregulla të qarta e të harmonizuara, me procedura të thjeshta dhe transparencë për investitorët vendës e të huaj.

- Zbatojmë Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3), me buxhet 1.18 miliardë euro, për të orientuar fondet kombëtare dhe ato të BE-së drejt fushave me avantazh konkurrues, duke mundësuar rritje të qëndrueshme, me shumë projekte inovative dhe integrim të plotë me tregjet evropiane.

- Përafrimë ligjet me standardet e BE-së, për mbrojtjen e patentave, markave dhe të drejtave të autorit, duke garantuar klimë të sigurt investimi, mbrojtje për produktet dhe shërbimet shqiptare dhe shpërblim për punën, talentin e shpikjet, si në çdo vend të BE-së.

- Miratojmë Politikën Kombëtare për NMV-të, u japim sipërmarrjeve shqiptare akses më të lehtë në kredi dhe fonde zhvillimi, duke rritur produktivitetin dhe transparencën, si dhe duke depërtuar më lehtë në tregjet ndërkombëtare. Kjo reformë nxit qëndrueshmërinë e bizneseve, krijon më shumë punësim lokal dhe rrit bazën prodhuese të vendit, duke i kthyer ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në bazën e mirëqenies së çdo familjeje shqiptare.

- Realizojmë Programin Kombëtar për Mbështetjen e Biznesit në Tregun Unik Evropian me qëllim orientim dhe asistencë për eksportuesit shqiptarë në përputhje me rregullat e BE-së.

- Përmirësojmë infrastrukturën institucionale të kontrollit të cilësisë dhe lidhjen me sistemet e BE-së që certifikatat shqiptare të njihen në mbarë BE-në.

- Forcojmë mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produkteve përmes një kuadri të ri ligjor, të përafruar me standardet e BE-së.

- Reformojmë Këshillin Ekonomik Kombëtar në Këshill Kombëtar Ekonomiko-Social, për përfshirje më të gjerë të partnerëve socialë dhe sektorit privat.

- Reformojmë sistemin e dhomave të tregtisë në Dhomë Ekonomike Kombëtare për përfaqësim të integruar të biznesit.

- Riorganizojmë të gjithë sistemin e inspektorateve për ta bërë më transparent, më efikas dhe më miqësor për biznesin, duke shmangur abuzimet dhe kontrollin e panevojshëm.

2.3 Inovacioni dhe teknologjia

a) Çfarë arritëm së bashku

Shqipëria ka hyrë në një epokë të re të inovacionit dhe transformimit digjital, duke e kthyer teknologjinë në një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe modernizimit të shtetit. Mbështetja për *startup*-et dhe sipërmarrjen e re ka marrë një dimension të ri: për periudhën 2022–2025 është krijuar një *fond* prej 10 milionë eurosh për financimin e ideve dhe bizneseve të reja inovative, me objektivin për të mbështetur mbi 250 *startup*-e.

Ky vizion ka marrë formë konkrete me ndërtimin e teknoparkut “Durana Tech Park”, ku tashmë mbi 50 kompani vendëse dhe të huaja kanë shprehur interes për t’u regjistruar, duke e vendosur Shqipërinë në hartën rajonale të inovacionit. Paralelisht, ligji për *startup*-et ka krijuar një kornizë të favorshme për nomadët digjitalë dhe profesionistët e huaj, duke u mundësuar atyre të punojnë nga Shqipëria për kompani ndërkombëtare.

Transformimi më i madh është realizuar në administratën publike, e cila është digjitalizuar pothuajse tërësisht. Platforma “*e-Albania*” ka ofruar mbi 47 milionë shërbime *online*, duke eliminuar sportelet, radhët dhe hapësirat për korrupsion. Ky proces është duke u thelluar me “*e-Albania 2.0*”, një version inovativ i bazuar në modelin “*life events*”, që ofron shërbime të personalizuar dhe asistencë të avancuar digjitale për qytetarët dhe bizneset.

Përfshirja e Inteligjencës Artificiale (IA) është një tjetër hap i madh: asistentja digjitale “Diella” është projektuar për të përfunduar automatikisht procese të tëra shërbimesh publike. Po ashtu, IA është integruar në administratën publike për të automatizuar prokurimet, analizuar të dhënat fiskale dhe për të forcuar luftën kundër evazionit tatimor.

Për të garantuar një shtet të sigurt digjital, është zgjeruar *GovNet*, rrjeti i sigurt i komunikimit ndërinstitucional. Në fushën e arsimit, janë ndërtuar 340 laboratorë inteligjentë në shkolla, me objektivin që deri në vitin 2026 të arrijë në 985 laboratorë, duke garantuar akses universal në teknologji për çdo fëmijë.

Një tjetër histori suksesi është hapja e qendrës TUMO në Piramidën e Tiranës, ku mësojnë falas mbi 1,500 të rinj të moshës 12–18 vjeç, duke u dhënë atyre aftësi digjitale dhe krijuese. Ndërkohë, sjellja në Shqipëri e “*Plug and Play*”, një nga platformat më të mëdha të *startup*-eve në botë, e ka pozicionuar Tiranën në hartën globale të inovacionit, përkrah kryeqyteteve më konkurruese të rajonit.

Së fundi, është hapur “*École 42*” në Tiranë, institucioni prestigjioz francez i teknologjisë, i cili formon çdo vit 250 programues të rinj, pa kriter akademike por vetëm mbi bazën e talentit. Kjo e bën Shqipërinë një qendër të re rajonale për edukimin në teknologji dhe përgatitjen e kapitalit njerëzor për ekonominë digjitale të së ardhmes.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë është që deri në vitin 2030, Shqipëria të bëhet lider në rajon për inovacionin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale, me një ekonomi digjitale të integruar në tregun evropian.

c) Punët tona përpara

- Trefishojmë fondet për *startup*-et dhe krijimin e inkubatorëve dhe akseleratorëve të rinj, duke fuqizuar sipërmarrësit e rinj dhe duke zgjeruar ekosistemin kombëtar të inovacionit.

- Zhvillojmë instrumentet e financimit alternativ, përmes “*crowdfunding*” fondeve korporative dhe investimeve engjëlllore (*Business Angels*), të mbështetura nga një trajtim fiskal i dedikuar dhe kuadër ligjor i posaçëm.

- Vendosim detyrimin për kërkim dhe zhvillim (R&D) për bizneset e mëdha, si mekanizëm për të nxitur inovacionin dhe konkurrueshmërinë.

- Vëmë në funksion sistemin “*AI-Assisted Investment Matching*”, që lidh automatikisht investitorët me *startup*-et më premtuese sipas potencialit ekonomik dhe ndikimit social.

- Krijojmë programe të veçanta për diasporën, për të tërhequr profesionistë dhe ekspertizë, duke ndërtuar ura mes talenteve jashtë vendit dhe mundësive ekonomike në Shqipëri.

- Forcojmë ekosistemin e *startup*-eve edhe jashtë Tiranës, duke krijuar kushte zhvillimi për sipërmarrjen në qytetet e vogla dhe zonat rurale.

- Zhvillojmë programe për inkubatorë dhe akseleratorë me fokus në teknologjitë e gjelbra dhe transformimin digjital, duke synuar një zhvillim të qëndrueshëm.

- Zgjerojmë teknoparket në qytete të tjera të vendit, duke ofruar infrastrukturë dhe lehtësi fiskale për bizneset inovative.

- Ngremë parqe ekoindustriale (eficiencë energjetike, riciklim, ekonomi qarkulluese) si qendra të reja prodhimi me paga më të larta.

- Krijojmë rrjetin NITTO të zyrave të transferimit të teknologjisë dhe inovacionit për lidhjen universitet-kërkim-biznes.

- Ngremë qendrat e ekselencës në nanoteknologji dhe shkencë biomarine për kërkim të aplikueshëm, patenta dhe vende pune të kualifikuara.

- Hartojmë dhe miratojmë ligjin për tregjet e kryptoaseteve, të përafuar me rregulloret më të fundit të BE-së, për të garantuar siguri dhe transparencë në financa.

- Çelim tregun për tokenizimin e asetëve të prekshme (prona, energji, bujqësi), duke krijuar mundësi të reja investimi vendëse dhe të huaja.

- Aplikojmë “*utility tokens*” për pagesa të sigurta e transparente në shërbime publike, si: ujë, energji, transport dhe taksa.

- Zbatojmë Programin Kombëtar “*Cashless Albania 2028*”, për ta shndërruar vendin në një ekonomi plotësisht digjitale, ku çdo transaksion është pa *cash*, më i shpejtë dhe më transparent.

- Krijojmë asistentin virtual për bizneset, për të lehtësuar integrimin në tregun evropian, duke ofruar akses në legjislacionin e BE-së, udhëzime mbi eksportet, hapjen e bizneseve dhe fondet e BE-së.

- Zhvillojmë asistentin virtual për administratën publike, i cili orienton institucionet mbi përafrimin e legjislacionit dhe procesin e negociatave me BE-në.

- Bëjmë Shqipërinë vendin e parë në Evropë që përdor inteligjencën artificiale për integrimin në BE, përmes modelit të zhvilluar nga AKSHI dhe Microsoft, duke harmonizuar legjislacionin shqiptar me atë të BE-së në vetëm 2 vjet.

- Krijojmë Qendrën e Rezervimit të të Dhënave (*Data Recovery Center*), për të garantuar sigurinë e informacionit dhe reziliencën e sistemeve elektronike.

2.4 Puna dhe kapitali njerëzor

a) Çfarë arritëm së bashku

Tregu i punës në Shqipëri është shndërruar në një motor të vërtetë zhvillimi dhe mirëqenieje për qytetarët, falë reformave të ndërmarra gjatë dekadës së fundit. Sot, vendi ka një treg pune më dinamik, më gjithëpërfshirës dhe më të lidhur ngushtë me nevojat reale të ekonomisë.

Papunësia është ulur në nivele historike: nga 17,5% në vitin 2014 në vetëm 8,8% në vitin 2024, duke krijuar mbi 300 mijë vende të reja pune. Këto vende pune kanë hapur mundësi të reja sidomos për të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabel, duke forcuar kohezionin social dhe duke zgjeruar bazën aktive të ekonomisë.

Në të njëjtën kohë, fuqia blerëse e qytetarëve është rritur ndjeshëm. Paga minimale është dyfishuar, duke garantuar stabilitet më të madh për familjet shqiptare, ndërsa paga mesatare në sektorin publik është rritur ndjeshëm, duke ofruar një vlerësim real dhe të merituar për çdo punonjës.

Shërbimet e punësimit janë modernizuar rrënjësisht. Sot Shqipëria renditet e para në Ballkanin Perëndimor për politikat e punësimit sipas OECD-së, si dëshmi e një sistemi më transparent dhe më efikas. Kjo është arritur edhe falë ngritjes së Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Punësimit, i cili ka krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë mes qytetarëve dhe bizneseve, duke eliminuar burokracinë dhe duke lehtësuar aplikimet për punë.

Një tjetër arritje e rëndësishme ka qenë fuqizimi i mbështetjes për të rinjtë me Garancinë Rinore, e cila garanton që çdo i ri të ketë mundësi punësimi, trajnimi apo edukimi brenda katër muajve. Kjo politikë ka vendosur një standard të ri të përputhjes mes sistemit arsimor, tregut të punës dhe nevojave të sipërmarrjes, duke i dhënë rinisë shqiptare një bazë më të fortë për zhvillim profesional dhe personal.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë strategjik është krijimi i një tregu pune konkurrues, gjithëpërfshirës dhe në linjë me standardet e BE-së, ku çdo qytetar shqiptar ka mundësi reale për punësim cilësor, paga të larta dhe zhvillim profesional të qëndrueshëm.

c) Punët tona përpara

Shërbime punësimi tërësisht digjitale dhe inteligjente

- Transformojmë shërbimet e punësimit me sistem të zgjuar orientimi karriere dhe platformë të dedikuara për emigrantët që duan të rikthehen e të punojnë në Shqipëri.

- Ulim papunësinë e përgjithshme në 6% deri më 2030 dhe papunësinë e të rinjve nën 15%.

- Paga minimale në 500 euro deri më 2026, me 18 muaj pa asnjë taksë shtesë për punëmarrësit me paga të ulëta.

- Paga mesatare kombëtare 1,000 € deri më 2030-n; në sektorin publik 1,200 €.

- Garancia rinore ofron punë, trajnim ose arsim për mbi 40,000 të rinj brenda 4 muajve nga regjistrimi.

- Forcojmë barazinë në paga dhe politikat aktive për punësimin e grave.

- Zgjerojmë modelin dual të arsimit profesional në partneritet me biznesin dhe certifikim ndërkombëtar të kualifikimeve.

- Deri më 2030-n, 1 në 3 nxënës ndjek arsimin profesional; shkollat profesionale kthehen në qendra multifunksionale me konvikte moderne dhe kurse afatshkurtra për profesione të kërkuara.

- Garantojmë kushte të barabarta pune, trajtim dinjitoz, sistem social të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

- Viojmë me nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për njohjen e pensioneve, duke siguruar kushte të barabarta pune dhe mbrojtje sociale të plotë për shqiptarët që jetojnë e punojnë jashtë vendit.

- Ndërtojmë programe të dedikuara për diasporën për rikthim të talenteve, transferim ekspertize dhe ndërmjetësim punësimi në sektorët prioritarë.

2.5 Infrastruktura moderne

a) Çfarë arritëm së bashku

Infrastruktura moderne është shndërruar në shtyllën e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Ajo është garancia e sovranitetit ekonomik, e integritit rajonal dhe e afërimit me Bashkimin Evropian. Vetëm me rrugë të standardeve evropiane, Shqipëria lidhet më shpejt dhe më sigurt. Vetëm me hekurudha moderne, të elektrifikuara, vendi bëhet pjesë e korridoreve të së ardhmes. Vetëm me porte dhe aeroporte funksionale Shqipëria hapet ndaj tregjeve globale. Vetëm me rrjete digjitale të avancuara qytetarët dhe bizneset bëhen pjesë e shoqërisë së informacionit. Së bashku e kthejnë Shqipërinë në një ekonomi konkurruese, një destinacion turistik të qëndrueshëm dhe një treg të integruar me Evropën.

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka përjetuar një transformim të thellë të infrastrukturës, duke e shndërruar atë në themel të rritjes së qëndrueshme. Janë ndërtuar mbi 935 km rrugë të reja, 21 km ura dhe 12 km tunele, Veriu i Shqipërisë është sot një motor i vërtetë zhvillimi dhe integrimi. Rruga e Arbrit me Tunelin e Murrizit dhe segmentin Maqellarë–Peshkopi ka hapur një arterie strategjike që lidh Tiranën me Dibërën dhe më tej me Maqedoninë e Veriut. Aksi Shëngjin–Velipojë ka sjellë një korridor të ri turistik përgjatë bregdetit verior, ndërsa *Bypass*-i i Shkodrës ka transformuar qarkullimin në një nga nyjat kryesore të vendit. Ndërhyrja në Kthesën e Berdicës–Ura e Bahçallëkut do e bëjë lëvizjen më të shpejtë, më të sigurt dhe më moderne, ndërkohë që Ura e Drinit ka bashkuar përfundimisht brigjet dhe komunitetet që e prisnin prej dekadash. Sot, veriu nuk është thjesht një hapësirë gjeografike, por një pol zhvillimi ku hapen tregje të reja për turizmin malor dhe kulturor, ku gjenerohet ekonomi e qëndrueshme dhe ku Shqipëria e Mesme, Veriu dhe Veri-Lindja bëhen një.

Paralelisht, Shqipëria ka avancuar me investime të mëdha në Korridorin VIII dhe Korridorin Blu, dy projekte që e pozicionojnë vendin si një strategjike të rrjeteve transevropiane të transportit. Shembulli më i qartë janë *Bypass*-i i Fierit, *Bypass*-i i Tepelenës dhe *Bypass*-i i Vlorës, vepra të përfunduara që kanë sjellë një transformim rrënjësor në qarkullimin kombëtar, duke ulur trafikun urban dhe duke rritur shpejtësinë, sigurinë dhe standardet evropiane të lëvizshmërisë. Ky vizion po forcohet më tej me segmentet e Korridorit Blu që janë në proces, si: Milot–Ballëdren, Milot–Thumanë, Kashar–Pezë–Lekaj dhe Lekaj–Konjat–Fier, si dhe me ndërtimin e një pjese të *Bypass*-it të Elbasanit, që lidh daljen e autostradës Tiranë–Durrës me Korridorin VIII në drejtim të Lekajt. Ky zhvillim shtrihet edhe në boshtin më të rëndësishëm të vendit, autostradën Tiranë–Durrës, ku zgjerimi i saj do ta kthejë në një korridor të integruar që lidh kryeqytetin me portin dhe aeroportin. Kjo tablo e transportit kombëtar kurorëzohet me Unazën e Madhe të Tiranës, tashmë të përfunduar, e cila e ka shndërruar kryeqytetin në një nyjë të vërtetë kombëtare dhe rajonale. Këto korridore kanë përgjysmuar kohën e udhëtimit dhe kanë rritur vlerën e pronës me mbi 50%, duke dëshmuar se infrastruktura është më shumë se rrugë dhe ura, është motor i gjallë i zhvillimit ekonomik dhe social. Këto janë jo vetëm vepra publike, por pjesë e një vizioni politik që e bën Shqipërinë pjesë të pandashme të korridoreve evropiane dhe gjithnjë më pranë anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Juglindja e Shqipërisë është afirmuar tashmë si një hapësirë zhvillimi dhe lidhjeje. Rruga Korçë–Ersekë ka hapur një arterie të re që e afron rajonin me qendrat kryesore të vendit dhe e ka kthyer në një destinacion të qasshëm për turizmin malor e kulturor. Segmenti Maliq–Lozhan i Ri ka lehtësuar lëvizjen për komunitetet bujqësore dhe i ka lidhur ato më shpejt me tregjet kombëtare. Projekti Lin–Pogradec ka modernizuar qarkullimin përgjatë liqenit të Ohrit, duke e shndërruar në një korridor turistik e kulturor me vlerë të shtuar për zonën. Ndërkohë, aksi strategjik Qukës–Qafë-Pllaçë do të lidhë Elbasanin me Korçën dhe Maqedoninë e Veriut, duke e futur juglindjen në qarkullimin e madh rajonal dhe panevropian. Sot, ky rajon është një portë e re bashkëpunimi, turizmi dhe zhvillimi për Shqipërinë që ecën me ritmin e Evropës.

Jugu i Shqipërisë po afirmohet si një hapësirë e re zhvillimi turistik dhe ekonomik, duke u kthyer në një destinacion të standardeve evropiane. Investimet e reja kanë hapur një epokë të re për këtë rajon, duke e bërë më të aksesueshëm, më të lidhur dhe më konkurrues në Mesdhe. Aksi

Kardhiq–Delvinë me Tunelin e Skërficës ka shkurtuar ndjeshëm distancën drejt Sarandës dhe rivierës së jugut, duke e kthyer atë në një destinacion më të afërt për çdo vizitor vendës dhe të huaj. Segmenti Orikum–Dukat me Tunelin e Llogarasë po shndërron lidhjen drejt Himarës dhe bregdetit të jugut, duke garantuar qarkullim të shpejtë dhe të sigurt gjatë gjithë vitit. Segmenti Palasë–Dhërmi ka sjellë një standard të ri për lëvizjen përgjatë rivierës, duke krijuar hapësira të reja për zhvillim turistik dhe investime të qëndrueshme. Sot, jugu i Shqipërisë është më i afërt, më i aksesueshëm dhe më i lidhur se kurrë. Ky rajon po e kthen potencialin turistik në zhvillim të prekshëm, po i jep vlerë trashëgimisë kulturore dhe natyrore si aset kombëtar dhe po ndërton themelet e një turizmi të qëndrueshëm. Ky është vizioni ynë, riviera shqiptare të bëhet një destinacion mesdhetar i nivelit më të lartë dhe një simbol i Shqipërisë që ecën përpara drejt integritetit evropian.

Siguria rrugore është themeli i infrastrukturës moderne. Shqipëria ka nisur përafrimin me standardet më të avancuara evropiane, duke vendosur në qendër Vision Zero, vizionin që asnjë jetë njerëzish të mos humbasë më në trafik. Investimet në rrugë nuk matin suksesin vetëm me kilometra të ndërtuar, por me jetë të shpëtuar, me udhëtime më të sigurta për çdo familje dhe me garancinë që Shqipëria ecën me të njëjtin standard sigurie si çdo vend i Bashkimit Evropian.

Në transportin ajror, Shqipëria ka hyrë në një fazë të re zhvillimi. Kapacitetet e Aeroportit të Tiranës janë trefishuar: numri i pasagjerëve është rritur nga 1.7 milionë në mbi 12 milionë vizitorë në vit, ndërsa rrjeti i destinacioneve është zgjeruar nga 6.7% në 32%, duke e kthyer hapësirën shqiptare në një nyjë të rëndësishme të lëvizjes në rajon. Hapja e Aeroportit të Kukësit, përrurimi i afërt i Aeroportit të Vlorës dhe në një të ardhme të afërt edhe Aeroporti i jugut (Gjirokastrës), shënojnë një epokë të re për lidhjet ajrore, duke e afruar Shqipërinë jo vetëm me Evropën, por edhe me tregjet globale. Ky zhvillim i shpejtë rrit edhe nevojën për kapacitete njerëzore të reja dhe profesionale. Për këtë arsye, më 27 shtator nis nga puna Akademia e Aviacionit, e para e këtij lloji në vend, që do të përgatisë pilotë, teknikë dhe specialistë, duke i dhënë Shqipërisë garanci afatgjatë për sigurinë dhe konkurrueshmërinë në sektorin ajror.

Në transportin detar, Porti i Durrësit po shndërrohet në një nga portet turistike më të mëdha të Mesdheut, ndërsa Porto-Romano po merr rolin e një qendre të fuqishme për tregtinë dhe logjistikën. Këto transformime e pozicionojnë Shqipërinë si një nyjë të pazëvendësueshme në hartën e korridoreve të zhvillimit rajonal dhe evropian.

Transporti hekurudhor ka hyrë në një fazë të re rilindjeje. Projekte kyçe si Tiranë–Durrës–Rinas, Durrës–Rrogozhinë dhe Rrogozhinë–Pogradec, Vorë–Hani i Hotit dhe Durrës–Prishtinë po rikthejnë hekurudhën si shtyllë të transportit modern. Këto linja do të garantojnë shpejtësi, siguri dhe ndërveprim të plotë me rrjetet panevropiane, duke e futur Shqipërinë në qarkullimin e madh të kontinentit.

Një tjetër hap vendimtar është bërë në infrastrukturën digjitale. Zgjerimi i rrjeteve *broadband* ka garantuar akses të gjerë në internet të shpejtë për qytetarët dhe bizneset, duke e bërë Shqipërinë më të lidhur, më të integruar dhe më konkurruese në epokën e ekonomisë digjitale. Ky zhvillim nuk është vetëm një investim teknologjik, por një hap i qartë drejt shoqërisë së informacionit evropian, ku transparenca, inovacioni dhe shërbimet publike të digjitalizuara janë pjesë e përditshme e jetës së qytetarëve.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë strategjik është modernizimi i plotë i infrastrukturës rrugore, hekurudhore, portuale, aeroportuale dhe digjitale deri në vitin 2030, duke e shndërruar Shqipërinë në një kyçe të Ballkanit Perëndimor dhe pjesë të pandashme të rrjeteve transevropiane të transportit dhe energjisë (TEN-T dhe TEN-E), si hap vendimtar drejt integritetit evropian.

c) Punët tona përpara

- Ndërtim dhe modernizim i rrjetit rrugor kombëtar

- Ndërtojmë 700 km rrugë të reja deri në vitin 2029, duke kompletuar rrjetin kombëtar me standarde moderne.

- Përfundojmë segmentet kyçe të Korridorit Blu: Milot–Balldren, Milot–Thumanë, Kashar–Pezë–Lekaj dhe Lekaj–Konjat–Fier, duke krijuar një bosht të ri të zhvillimit kombëtar.

- Ndërtojmë segmentin ndërlidhës të *Bypass*-it të Elbasanit, që bashkon autostradën Tiranë–Durrës me Korridorin VIII në drejtim të Lekajt, duke krijuar një lidhje të plotë dhe funksionale mes boshtit perëndimor dhe korridoreve transevropiane.

- Përfundojmë Rrugën e Bregut (Dhërmi–Sarandë), së bashku me *Bypass*-in e Sarandës dhe rrugën e Ksamilit, duke garantuar akses të plotë dhe zhvillim turistik të qëndrueshëm në rivierën shqiptare.

- Realizojmë Unazën e Çajupit (Gjirokastër–Libohovë–Kardhiq), duke krijuar një lidhje të re funksionale mes jugut të brendshëm dhe rrjetit kombëtar.

- Përmbyllim Rrugën e Vjosës (Ersekë–Përmet–Tepelenë), duke shndërruar luginën në një korridor zhvillimi dhe lidhur juglindjen me jugun.

- Ndërtojmë aksin Berat-Skrapar-Gramsh, duke hapur mundësi të reja turistike dhe ekonomike në Shqipërinë e Mesme.

- Realizojmë Rrugën e Liqeneve (Rrëshen–Burrel), duke shtuar aksesin dhe ndërlidhjen e Dibrës me rrjetin kombëtar.

- Përmbyllim Rrugën e Maleve (Vau i Dejës–Pukë–Fushë–Arrëz), duke garantuar lidhje më të shpejta e më të sigurta për veriun e thellë dhe duke gjeneruar zhvillim të qëndrueshëm.

- Qendër Kombëtare e Monitorimit të Trafikut

- Zgjerojmë kapacitetin e QKMT-së me 1,200 km rrugë të monitoruara deri në vitin 2029, për një lëvizshmëri më të sigurt, efikase dhe digjitale.

- Transport hekurudhor i ringjallur

- Operacionalizojmë linjën Tiranë–Durrës–Rinas me flotë të re EMU.

- Ndërtojmë segmentin Tiranë Qendër–PTT dhe linjën Sukth–Porto-Romano.

- Garantojmë ndërlidhjen rajonale me projektet Vorë–Hani i Hotit, Durrës–Rrogozhinë dhe Rrogozhinë–Pogradec, me investime mbi 800 milionë euro.

- Ndërtojmë linjën Vlorë–Via dhe vendosim në operim një flotë moderne me standarde evropiane.

- Rrjet kombëtar transporti publik dhe i gjelbër

- Ngremë shoqërinë shtetërore MobAl si Agjenci Kombëtare për Transportin Publik, që në fazën fillestare ofron shërbime në 7 itinerare turistike kombëtare dhe ofron transport publik shkollor në tri zona të vendosura strategjikisht në veri, jug dhe juglindje, aty ku nxënësit kanë vështirësi në aksesimin e shkollës, duke garantuar mundësi të barabarta arsimimi për çdo fëmijë.

- Vëmë në funksion një flotë prej rreth 100 autobusësh elektrikë, me standarde të reja sigurie, efikasiteti dhe respekti për mjedisin.

- Implementojmë sistemet elektronike të biletave dhe GPS/AVL, duke garantuar menaxhim transparent, monitorim në kohë reale dhe shërbim të besueshëm për qytetarët.

- Garantojmë përfitime sociale afatgjata: uljen e braktisjes shkollore, reduktimin e pabarazive territoriale dhe mbështetjen e fuqisë punëtore në turizëm, duke i dhënë vendit një transport publik që shërben për qytetarët dhe zhvillimin ekonomik.

- Portet dhe infrastruktura detare.

- Ndërtojmë Portin e ri tregtar të Porto-Romanos, të integruar me rrjetin hekurudhor.

- Zbatojmë masterplanin e marinave turistike për Sarandën, Vlorën dhe Kepin e Rodonit.

- Transport ajror.

- Përfundojmë certifikimin dhe operimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.

- Hapim Aeroportin e Jugut (Gjirokastër), duke zgjeruar rrjetin ajror kombëtar.

- Zgjerojmë kapacitetet e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (VIA) për të rritur trafikun e pasagjerëve dhe numrin e destinacioneve ndërkombëtare.

- Themelojmë Akademinë e Aviacionit, të parën në vend, si qendër kombëtare për përgatitjen e pilotëve, teknikëve dhe specialistëve, duke i dhënë Shqipërisë kapacitetet njerëzore që e bëjnë një aktor të plotë dhe konkurrues në qiellin evropian.

- Transport i gjelbër dhe i qëndrueshëm

- Investime të dedikuara për flota elektrike, stacione karikimi dhe mobilim urban të autostradave, për një qarkullim më të sigurt e estetik, me fokus në uljen e ndotjes dhe rritjen e efikasitetit energjetik.

- Ujë të pijshëm 24 orë dhe kanalizime moderne

- Furnizim 24 orë me ujë të pijshëm në 100% të zonave urbane dhe në mbi 80% të zonave rurale deri në vitin 2030.

- Krijojmë Operatorin Shtetëror të Prodhimit të Ujit si strukturë kombëtare të unifikuar që administron burimet ujore, garanton cilësi, mbrojtje dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

- Shpërndarja dhe furnizimi konsolidohen si funksion duke siguruar mirëmbajtjen e rrjeteve dhe reduktimin e humbjeve, ndërsa konsumatori merr shërbim transparent, faturim korrekt dhe shërbim efikas.

- Digjitalizim i plotë i shërbimeve përmes sensorëve, monitorimit në kohë reale dhe inteligjencës artificiale, duke garantuar kontroll modern dhe menaxhim të integruar.

2.6 Turizmi

a) Çfarë arritëm së bashku

Transformimi i Shqipërisë në një destinacion turistik të njohur ndërkombëtarisht është një nga historitë më të mëdha të suksesit të dekadës së fundit. Nga një vend që në vitin 2013 priste vetëm 1 milion vizitorë, sot Shqipëria mirëpret mbi 12 milionë turistë në vit, duke e kthyer turizmin në një nga shtyllat kryesore të ekonomisë. Të ardhurat nga turizmi janë rritur nga më pak se 1 miliard euro në afro 5 miliardë euro, duke gjeneruar zhvillim dhe vende pune në çdo cep të vendit.

Nga një sezon i kufizuar 2–3-mujor, Shqipëria është bërë sot një destinacion turistik gjithëvjetor. Investime të rëndësishme infrastrukturore, si Tuneli i Llogarasë, rruga Kardhiq–Delvinë dhe rruga Shkodër–Theth, kanë lehtësuar ndjeshëm lëvizjen e vizitorëve drejt Rivierës shqiptare, zonave malore dhe destinacioneve të thella rurale.

Turizmi është shtrirë në kohë, territor dhe larmi. Agroturizmi numëron mbi 270 njësi aktive, ekoturizmi ka tërhequr mbi 5.5 milionë vizitorë brenda një viti, ndërsa turizmi kulturor ka regjistruar mbi 1 milion vizitorë në kala, muze dhe *site* arkeologjike, duke gjallëruar ekonominë lokale dhe duke sjellë zhvillim të shpërndarë në të gjithë territorin.

Në arenën ndërkombëtare, Shqipëria është promovuar në panairët më prestigjioze të turizmit, si ITB Berlin dhe FITUR Madrid, duke kulmuar me shpalljen e saj si “Vendi i Nderit” në ITB Berlin 2025, panairi më i madh i turizmit në botë. Ky vlerësim ka rritur dukshmërinë globale të Shqipërisë si destinacion unik mesdhetar.

Përmirësimi i ofertës dhe standardeve të shërbimit ka qenë po ashtu një prioritet. Janë kategorizuar mbi 2,200 struktura akomoduese dhe janë certifikuar 650 udhërrëfyes turistikë, duke ngritur cilësinë e eksperiencës për turistët.

Shqipëria ka tërhequr gjithashtu investime të mëdha nga markat ndërkombëtare të hotelierisë: 17 hotele me pesë yje janë përfunduar ose janë në proces, duke rritur konkurrencën, cilësinë e ofertës dhe duke krijuar mijëra vende të reja pune. Këto zhvillime e kanë forcuar turizmin si një nga shtyllat më të qëndrueshme dhe me potencialin më të madh për rritjen ekonomike të vendit.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë është që deri në vitin 2030, Shqipëria të konsolidohet si një destinacion turistik i nivelit të lartë në Mesdhe, me turizëm gjithëvjetor, të qëndrueshëm dhe konkurrues në tregun evropian dhe global.

c) Punët tona përpara

- Orientojmë politikat dhe investimet në turizëm të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.
- Krijojmë, menaxhojmë dhe brandojmë Shqipërinë në 6 rajone turistike sipas strategjisë Shqipëria Turistike 2030, duke garantuar ofertë të diversifikuara dhe standarde të larta ndërkombëtare.
- Transformojmë Portin e Durrësit në një qendër moderne për kroçera dhe jahte luksoze.
- Ndërtojmë 20 marina të reja nga Velipoja në veri deri në Ksamil në jug, duke e bërë Shqipërinë një destinacion lider për turizmin detar në Mesdhe.
- Dyfishojmë netqëndrimet turistike, duke gjeneruar mbi 6.6 miliardë euro të ardhura vjetore deri në vitin 2030.
- Zhvillojmë turizmin malor në Alpe dhe zona natyrore, duke e bërë Shqipërinë destinacion për sporte dimërore dhe eksperiencë unike.
- Investojmë në promovimin e *sit-eve* të trashëgimisë kulturore dhe digjitalizimin e kalendarëve kulturorë, duke e bërë Shqipërinë një “muze të hapur”.
- Konsolidojmë infrastrukturën logjistike për të kthyer Shqipërinë në një pol të konferencave, panaireve dhe ekspozitave ndërkombëtare.
- Realizojmë Platformën Digjitale të Integruar të Turizmit, që përfshin:
 - Regjistrin kombëtar digjital të turizmit për sipërmarrjet.
 - Platformën *e-Visitor* për regjistrimin elektronik në kohë reale të vizitorëve.
 - Sistemin elektronik të të dhënave në turizëm për statistika të sakta dhe vendimmarrje më efektive.
 - Themelojmë Akademinë Ndërkombëtare të Turizmit dhe Mikpritjes, në bashkëpunim me UN Tourism, për të formuar brezin e ri të profesionistëve.
- Sigurojmë një administrim më të drejtë të plazheve, duke garantuar më shumë hapësira publike dhe qetësi për pushuesit.

2.7 Bujqësia dhe zhvillimi rural

a) Çfarë arritëm së bashku

Bujqësia dhe ekonomia blu janë transformuar nga sektorë të mbijetesës në motorë zhvillimi modern, duke rritur produktivitetin, eksportet dhe integrimin e Shqipërisë në tregjet evropiane. Falë investimeve të vazhdueshme, sot produktet bujqësore shqiptare eksportohen në 80 tregje ndërkombëtare, ndërsa vlera e eksporteve ka arritur në 532 milionë euro në vitin 2024, mbi pesëfish më e lartë se një dekadë më parë. Përmirësimi i bilancit tregtar është i dukshëm: nga një raport 1:9 në vitin 2013, sot është ulur në më pak se 1:3, duke forcuar konkurrueshmërinë e prodhimit vendës.

Mbështetja për fermerët është rritur në mënyrë historike. Subvencionet bujqësore janë pesëfishuar, duke arritur në 5.2 miliardë lekë, ose 40% të buxhetit të Ministrisë. Nga vetëm 5,600 përfitues në vitin 2013, sot mbi 67,100 fermerë marrin mbështetje përmes skemave të naftës pa akcizë, teknologjive moderne dhe granteve. Kjo ka nxitur modernizimin e prodhimit dhe rritjen e produktivitetit.

Janë investuar mbi 250 milionë dollarë në sistemet ujëtare, duke rritur me 120,000 hektarë sipërfaqen e tokës së ujitur. Ndërkohë, sipërfaqja e serrave është trefishuar, duke arritur në 2,116 hektarë në vitin 2024, çka ka zgjeruar ndjeshëm prodhimin e kontrolluar dhe konkurrueshmërinë në treg.

Në fushën e sigurisë ushqimore, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV) realizon sot mbi 2,000 teste të akredituara, duke garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve vendëse sipas standardeve të BE-së. Paralelisht, agroturizmi është bërë një aset kombëtar: çdo njësi agroturistike mbështet mesatarisht 22 familje dhe 11 hektarë tokë, duke gjeneruar të ardhura dhe zhvillim lokal.

Edhe ekonomia blu po zhvillohet me ritme të shpejta. Eksportet e akuakulturës kanë arritur në 140 milionë euro, ndërsa projektet për ndërtimin e markatave moderne dhe infrastrukturës për peshkimin artizanal po krijojnë bazën për një trefishim të prodhimit deri në vitin 2030. Ky sektor po bëhet një burim i ri i qëndrueshëm i rritjes ekonomike, duke lidhur zhvillimin bujqësor dhe detar me standardet e gjelbra dhe konkurrencën evropiane.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë strategjik është transformimi i bujqësisë shqiptare në një sektor modern, konkurrues dhe të qëndrueshëm, plotësisht të integruar në Politikat e Përbashkëta Bujqësore dhe Ushqimore të BE-së deri në vitin 2030.

c) Punët tona përpara

- Mbështesim prodhimin bujqësor me objektivin që eksportet bujqësore dhe peshkimi/akuakultura të arrijnë 1 miliard € deri më 2030.

- Program i posaçëm për perimet në sera dhe kulturat me vlerë të lartë, të lidhura me tregun e BE-së dhe turizmin.

- Ndërtojmë 5 qendra moderne për ruajtjen/përpunimin e produkteve të freskëta, të lidhura me tregun vendës dhe kanalet HORECA/turizëm.

- Shtojmë 1,000 ha serra të reja për prodhim dhe eksport gjithëvjetor.

- Ndërtojmë markata moderne të peshkut dhe pika të reja tregtimi, duke fuqizuar peshkimin dhe duke krijuar destinacione turistike për produktet e detit.

- Zbatojmë menaxhim të qëndrueshëm të resurseve: planet e menaxhimit në Adriatik, zona të përcaktuara të akuakulturës në det e ujëra të brendshme; 20,000 t/vit akuakulturë detare dhe 10,000 t/vit në ujërat e brendshme deri më 2030.

- Digjitalizojmë kontrollin e peshkimit; reformojmë inspektimin dhe transformojmë OMP-të në Organizata Prodhuese (OP) sipas modelit të BE-së.

- Garantojmë sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve nëpërmjet përafrimit të plotë ligjor e institucional dhe modernizimit të laboratorëve.

- Zgjerojmë investimet në rrjetin laboratorik rajonal dhe në PIK, si dhe rrisim kapacitetet njerëzore në ISUV dhe rolin e institucionit në funksion të kontrollit zyrtar.

- Reformojmë sistemin e Inspektimit dhe Kontrollit edhe në kuadër të ligjit të ri të inspektimit, duke e përafruar inspektimin me standardet dhe protokollat e BE-së.

- Ndërtojmë bazat e të dhënave digjitale dhe platformën kombëtare për bujqësinë e zgjuar: integrim i të dhënave të fermave, laboratorëve, klimës dhe satelitëve; AI për parashikime të prodhimit, zbulim të hershëm të sëmundjeve dhe këshillim të personalizuar për fermerët.

- Vëmë në funksion në gjithë vendin sistemin e të dhënave për kontabilitetin e fermave, informacionin për çmimet e produkteve bujqësore si edhe standardet e tregimit për të gjitha llojet e produkteve bujqësore.

- Aplikojmë përdorimin e dronëve për mbrojtje të lokalizuar të bimëve, duke ulur përdorimin e pesticideve dhe mbetjeve në produkte, duke siguruar cilësi më të lartë dhe një bujqësi më të qëndrueshme.

- Ofrojmë mbështetje direkte dhe investime me rreth 100 mln €/vit sipas praktikave të CAP-it; kondicionalitet për mjedisin, higjienën, gjurmueshmërinë dhe mirëqenien e kafshëve; 150,000 fermerë përfitues të regjistruar në shkallë vendi.

- Kalojmë nga ferma e vogël tradicionale tek ferma moderne e lidhur me tregun nëpërmjet “Contract Farming”, nxitjen e krijimit të SHBB-ve/kooperativa dhe modeleve të ekonomisë së shkallës duke filluar pilotimin në 5 bashki.

- Zbatojmë programin sektorial për bagëtitë e imta: kushte mbarështimi, produktivitet, certifikim i produkteve autoktone për tregjet e BE-së.

- Përfundojmë 100% ujitjen e tokës bujqësore: nga 270,000 ha sot në 360,000 ha deri më 2030; modernizim në 290,000 ha, shtim përmes stacioneve të pompimit në 70,000 ha.

- Rindërtojmë dhe modernizojmë rreth 250 diga, duke rikthyer në parametra optimale të kullimit afërsisht 280,000 hektarë tokë bujqësore; ndërtojmë edhe 150 kilometra struktura mbrojtëse kundër përmytjeve dhe gërryerjes në lumenjtë kryesorë.

- Riorganizojmë ekstensionin dhe QTTB-të në qendra të këshillimit dhe transferimit të dijes, duke u mbështetur te praktikat më të mira dhe teknologjia.

2.8 Energjia

a) Çfarë arritëm së bashku

Energjia ka qenë një fushë ku Shqipëria ka bërë hapa historikë, duke garantuar siguri furnizimi dhe transformim të sektorit. Gjatë krizës globale energjetike, Shqipëria mbajti të pandryshuar çmimin e energjisë për konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla, duke mbrojtur fuqinë blerëse të qytetarëve dhe duke shmangur goditje sociale. Për herë të parë pas 34 vjetësh, u mundësua edhe një ulje me 10% e çmimit të energjisë elektrike, nga e cila përfituan 95% e konsumatorëve familjarë.

Në aspektin prodhues janë dyfishuar kapacitetet, nga 1,768 MW në 3,298 MW, ndërsa humbjet në shpërndarje u ulën nga 50% në rreth 17%, duke forcuar stabilitetin financiar të sektorit. Paralelisht, është mbështetur fuqishëm vetë prodhimi i energjisë: vetëm përmes paneleve diellore, qytetarët dhe bizneset kanë instaluar mbi 210 MW kapacitete të reja. Janë financuar mbi 2,000 sisteme diellore për ngrohjen e ujit, është zbatuar skema e matjes neto, si dhe janë rehabilituar energjetekisht 16 godina publike dhe rezidenciale.

Në fushën e burimeve të rinovueshme, Shqipëria ka bërë hapa gjigantë në linjë me politikat evropiane për integrimin e burimeve të rinovueshme. Centrali fotovoltai i Karavastasë me kapacitet 140 MW është sot investimi më i madh i këtij lloji në vend, ndërkohë që janë shtuar 1,300 MW kapacitete të reja nga burimet diellore e të tjera të gjelbra. Si rezultat, 10% e energjisë së prodhuar sot vjen nga fotovoltai, duke diversifikuar burimet, ulur varësinë nga hidrocentralet dhe klasifikuar sistemin energjetik ndër më të qëndrueshmit në nivel global.

Në planin institucional, është krijuar Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX) dhe janë forcuar interkoneksionet rajonale, duke integruar Shqipërinë më ngushtë me tregjet evropiane të energjisë.

Në planin rregullator, sot sistemi energjetik shqiptar mbështet zhvillimin e tij në parimet e Integritimit në Tregun Evropian të Energjisë.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë është që deri në vitin 2030, Shqipëria të shndërrohet në një eksportues neto të energjisë së pastër në rajon, duke u bërë një vend lider në Ballkan për prodhimin, diversifikimin dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në tregun evropian të energjisë.

c) Punët tona përpara

- Përafrojmë ligjin e sektorit të energjisë me Paktën e Integritimit të Energjisë së BE-së, për një sektor me vizion të qartë drejt integritimit në tregu evropian.

- Përmirësojmë rrjetin e shpërndarjes me investime të koordinuara të OST-së dhe OSSH-së, duke garantuar furnizim të qëndrueshëm me energji për zonat me intensitet të lartë zhvillimi.

- Ulim humbjet në shpërndarje në më pak se 12% bazuar në teknologjitë e reja të matjes.

- Diversifikojmë burimet gjeneruese duke shtuar 500 MW të rinj nga burimet e rinovueshme dhe duke synuar rritje me 1,500 MW deri në vitin 2030.

- Ndërtohet parku më i madh eolik në vend me kapacitet prej 600 MW, në Tropojë.

- Rivitalizojmë TEC-in e Vlorës përmes konvertimit në gaz natyror, duke shtuar 250 MW kapacitete të reja prodhimi dhe duke lidhur infrastrukturën me TAP.

- Gazifikojmë qytetin e Korçës me investime mbi 50 milionë euro në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.

- Konvertojmë TEC-et lundruese në gjirin e Vlorës nga nafta në gaz natyror, duke ulur ndotjen dhe duke rritur sigurinë energjetike.
- Trefishojmë kapacitetin e eksportit të energjisë në 3,000 MW, duke e pozicionuar Shqipërinë si një kyçe në tregjet evropiane.
- Forcojmë ndërlidhjen rajonale përmes linjave të reja të interkonjeksionit: Shqipëri–Greqi, Shqipëri–Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri–Kosovë.
- Nisim ndërtimin e linjës së re nënujore Shqipëri–Itali për integrim të plotë në tregun evropian të energjisë.
- Rrisim kapacitetin depozitues me projektet e “*Pump Storage*”: Koman–Fierzë (200 MW) dhe Kaskada e Devollit (1,200-1,600 MW), duke siguruar stabilitet për burimet e rinovueshme dhe rezervë strategjike energjie.
- Ndërtojmë rrjetin inteligjent të energjisë elektrike në transmetim dhe shpërndarje dhe sigurojmë integrim në tregun evropian të energjisë.
- Zbatojmë Planin Kombëtar të Rinovimit të Ndërtesave me fonde të dedikuara (30–35 milionë euro/vit), duke rinovuar stokun publik e privat sipas standardeve të BE-së dhe duke ulur ndjeshëm konsumin e energjisë.
- Mbështesim përdorimin e paneleve diellore, sistemeve qendrore të ngrohjes/ftohjes dhe biokarburanteve, me subvencione dhe skema incentivimi.
- Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, mbështesim kërkimin dhe inovacionin në sektorin energjetik kombëtar.
- Krijojmë Akademinë e Energjisë.
- Krijojmë kompaninë shtetërore të tregut të naftës, për të garantuar ulje drastike të çmimit fundor, në dobi të konsumatorit shqiptar.
- Krijojmë FTL Charge by OSHEE, për krijimin e kushteve të favorshme për flotat elektrike.

SHTYLLA III MIRËQENIE PËR TË GJITHË

3.1 Arsimi dhe formimi profesional

a) Çfarë arritëm së bashku

Arsimi në Shqipëri ka kaluar në një fazë modernizimi të thellë gjatë dekadës së fundit, duke u përqendruar te përmirësimi i cilësisë, barazisë në akses dhe përafrimi me standardet e Bashkimit Evropian. Investimet e mëdha kanë bërë të mundur ndërtimin ose rikonstruksionin e mbi 450 shkollave dhe objekteve sportive, duke përmirësuar kushtet e të nxënësve për mbi 250 mijë nxënës dhe mësues.

Në fushën e teknologjisë, janë vendosur mbi 340 laboratorë inteligjentë, me objektivin për të arritur 1000 laboratorë brenda vitit 2026 e duke garantuar që çdo shkollë të pajiset me infrastrukturë digjitale moderne. Paga mesatare e mësuesve është dyfishuar, nga 420 euro në mbi 950 euro, dhe parashikohet të arrijë 1,250 euro brenda vitit 2030.

Në arsimin profesional është duke u zbatuar sistemi dual, duke lidhur shkollat me bizneset dhe duke trefishuar numrin e ndërmarrjeve që ofrojnë praktika profesionale.

Në arsimin e lartë është trefishuar buxheti, duke financuar nga 69 milionë euro në mbi 200 milionë euro. Dyfishuam investimet në kërkim shkencor dhe infrastrukturë, ndërsa për herë të parë është realizuar procesi i akreditimit institucional dhe u programave të studimit në universitetet publike dhe private.

Ndërkombëtarizimi i universiteteve shqiptare ka hyrë në një fazë të re me hapjen e kampusit të Kolegjit të Evropës në Tiranë, nisjen e programeve të harmonizuara dhe diplomave të dyfishta mes

Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe BOKU-t të Vjenës, si dhe hapjen e kampusit të UNED-it (Universiteti Kombëtar i Arsimit në Distançë i Spanjës) në Gjirokastrë, që përbëjnë hapa konkretë të strategjisë së qeverisë për ta përfshirë arsimin e lartë shqiptar në hapësirën akademike evropiane dhe për të ofruar një ofertë akademike cilësore dhe që i përgjigjet kërkesave të tregut të punës.

b) Destinacioni ynë evropian

Ngremë arsimin shqiptar në lartësinë e standardeve evropiane, duke e bërë shkollën urën e së ardhmes ku çdo fëmijë dhe i ri gjen mundësi për t'u rritur, për t'u formuar dhe për të qenë një qytetar dinjitoz i Evropës.

Për ta arritur këtë, do të investojmë për një sistem arsimit publik, të drejtë e cilësor, të digjitalizuar dhe gjithëpërfshirës, që garanton barazi shansesh, fuqizon mësuesit dhe autonominë me llogaridhënie në universitete, dhe e lidh fort me ekonominë përmes arsimit profesional dual, STEM-it dhe kërkimit të aplikuar.

c) Punët tona përpara

- Rrisim pagën mesatare të mësuesve në 1,250 euro deri në vitin 2029.
- Ndërtojmë 200 shkolla të reja, të pajisura me infrastrukturë evropiane dhe teknologji moderne, për të garantuar arsim cilësor për çdo nxënës.
- Vendosim 1000 laboratorë inteligjentë në shkolla deri në vitin 2027, duke garantuar akses për çdo nxënës në mësimin e teknologjisë digjitale.
- Zgjerojmë shërbimet arsimore *online*, digjitalizojmë testimet dhe sigurojmë njohjen automatike të diplomave, përmes ngritjes së një agjencie të specializuar dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare.
- Zbatojmë programin e ushqimit në çdo bashki qendër qarku dhe nisim një program të ri passhkollor (*after school*), brenda mandatit të katërt.
- Zhvillojmë kurrikula të reja ku teknologjia digjitale, inovacioni dhe intelijenca artificiale janë pjesë integrale, ndërsa të gjithë mësuesit trajnohen për t'i zbatuar ato me aftësi digjitale dhe metoda bashkëkohore të mësimdhënies.
- Garantojmë tekstet falas për 236 mijë nxënës të arsimit bazë, nxënësit e pakicave kombëtare dhe kategori të veçanta sociale të shkollave të mesme.
- Digjitalizojmë arsimin dhe integrojmë inteligjencën artificiale në mësimdhënie e mësimnxënie, duke siguruar tekste shkollore *online* përmes platformës SMIP dhe shërbime digjitale të plota nga regjistrimet deri tek komunikimi me prindërit.
- Investojmë për pajisjen e shkollave me kamera inteligjente, dyfishojmë numrin e oficerëve të sigurisë dhe rrisim prezencën e psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla.
- Rrisim numrin e mësuesve ndihmës për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe investojmë në klasa burimore në çdo shkollë, si edhe në platforma të personalizuar të mësimdhënies sipas nevojave specifike të nxënësve.
- Ngremë shoqërinë publike të transportit shkollor dhe nisim ofrimin e transportit falas për nxënësit dhe mësuesit që udhëtojnë në distancë nga vendbanimi i tyre, në zona të caktuara.
- Mbështesim zhvillimin e shkollave me orientim artistik dhe sportiv, duke garantuar autonominë dhe mbështetjen e tyre financiare, si dhe ngremë një model të ri shkolle me drejtim shkencor dhe fokus tek inovacioni, duke filluar me hapjen e Liceut Franko-Shqiptar.
- Zgjerojmë brenda vitit 2027 programin e mbështetjes financiare për mësuesit në diasporë dhe forcojmë mbështetjen për fëmijët dhe mësuesit e gjuhës shqipe me libra falas dhe me krijimin e platformës së mësimi të gjuhës dhe kulturës shqiptare.
- Dyfishojmë numrin e nxënësve në arsimin profesional duke investuar 60 milionë euro në ndërtimin e shkollave profesionale dhe instalimin e laboratorëve teknikë.

- Arrijmë që 35% e numrit të përgjithshëm të nxënësve të ndjekin arsimin profesional dhe garantojmë që deri në vitin 2030 të gjithë nxënësit e arsimit profesional të kenë konvikte me standarde evropiane.

- Kthejmë ndërkombëtarizimin e universiteteve në udhërrëfyes të politikave zhvillimore në arsimin e lartë, duke synuar hapjen e filialeve të universiteteve prestigjioze ndërkombëtare dhe shtimin e programeve të përbashkëta, të dyfishta dhe në gjuhë të huaj.

- Hapim pranë Universitetit Politeknik të Tiranës kampusin e Universitetit Teknologjik të Compiègne, duke pasuruar ofertën akademike për studentët vendës dhe të huaj.

- Përfshijmë diasporën akademike në hartim politikash, mësimdhënie dhe kërkim shkencor, përmes programeve qeveritare, që përcjellin eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe krijojnë ura bashkëpunimi.

- Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore.

- Nisim mbështetjen financiare për programe doktorale për kërkuesit e rinj, duke përfshirë diasporën akademike dhe nxitjen e bashkëpunimit akademi-biznes, me synim që sistemi i kërkimit shkencor në Shqipëri të përthithë fonde të krahasueshme me vendet e BE-së nga *programi Horizont Europe*.

- Përmirësojmë infrastrukturën universitare dhe kërkimore përmes ngritjes së kampuseve të reja dhe investimeve madhore, duke nisur ndërtimin e kampusit të Universitetit të Tiranës dhe Kolegjit të Evropës, zhvilluar kampusin e Universitetit të Durrësit, përfunduar investimet në kampuset e Universitetit Politeknik dhe ndërtuar Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Universitetin e Elbasanit.

3.2 Shëndetësia

a) Çfarë arritëm së bashku

Shëndetësia në Shqipëri është transformuar në një prioritet strategjik të qeverisë gjatë dekadës së fundit. Buxheti i sektorit është trefishuar, duke kaluar nga 250 milionë euro në vitin 2013 në mbi 760 milionë euro në vitin 2025, çka ka mundësuar rritjen e kapaciteteve spitalore dhe shërbimeve të kujdesit parësor.

Janë ndërtuar ose rindërtuar 53 spitale dhe shërbime, nga të cilët 10 të rinj dhe 43 të rikonstruktuar, përfshirë Spitalin Memorial të Fierit si model i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe inovacionit. Gjithashtu, janë rehabilituar mbi 400 qendra shëndetësore dhe ambulanca në të gjithë territorin, duke përmirësuar aksesin dhe cilësinë e shërbimit.

Fondi i barnave të rimbursueshme është dyfishuar dhe lista është zgjeruar me 200 medikamente të reja. Rreth 210 mijë pensionistë përfitojnë barnat e tyre falas. Flota e autoambulancave është rritur në 320 mjete moderne, duke garantuar kohë reagimi në 15 minuta në të gjithë territorin.

Një arritje madhore ka qenë rritja e pagave për personelin shëndetësor: paga mesatare e mjekëve është trefishuar nga 490 euro në 1,670 euro, ndërsa ajo e infermierëve është rritur nga 280 euro në 850 euro, duke forcuar motivimin dhe cilësinë e shërbimit.

b) Destinacioni ynë evropian

Një shëndetësi moderne, gjithëpërfshirëse dhe efikase, që ecën hap pas hapi drejt standardeve më të avancuara evropiane. Një sistem ku çdo qytetar, pa dallim, gjen kujdes falas, cilësor dhe në kohë, të mbështetur mbi forcimin e kujdesit parësor, modernizimin e spitaleve, digjitalizimin e shërbimeve dhe motivimin e profesionistëve tanë.

c) Punët tona përpara

- Rindërtojmë plotësisht të gjitha qendrat shëndetësore dhe ambulancat deri në vitin 2029.

- Transformojmë QSUT “Nënë Tereza” në një qendër ekselence në rajon për trajtimin, edukimin dhe inovacionin mjekësor, nëpërmjet bashkëpunimeve me spitalet më elitare ndërkombëtare.

- Bëjmë realitet Shëndetësinë Digjitale, me receta dhe referime elektronike, sisteme të integruara spitalore dhe regjistra kombëtarë, që shërbimi të jetë më i shpejtë, më transparent dhe i harmonizuar me standardet më të avancuara të Bashkimit Evropian.

- Programi i Kontrollit Shëndetësor Bazë do të vazhdojë të ofrohet falas, ndërkohë për të gjithë pensionistët nuk do të ketë më limit moshe.

- Rrisim pagat e mjekëve dhe infermierëve me 25% deri në vitin 2029 për të ruajtur konkurrueshmërinë.

- Forcojmë kapacitetet diagnostikuese për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve kronike.

- Realizojmë harmonizimin me mekanizmat evropianë të reagimit ndaj krizave shëndetësore, për një mbrojtje më të mirë ndaj epidemive dhe pandemive.

- Rrisim kapacitetet spitalore përmes autonomisë financiare të spitaleve, duke u dhënë më shumë hapësirë për investime të dedikuara.

- Rrisim numrin e mjekëve dhe infermierëve në sistem, duke u afruar standardeve të BE-së për raportin në numër banorësh.

- Sigurojmë aksesin universal në barnat dhe trajtimet moderne e inovatore, duke garantuar cilësi dhe mbulim të barabartë për të gjithë qytetarët.

- Zhvillojmë shërbime të shëndetit mendor me bazë komunitare, me theks tek fëmijët dhe të rinjtë, duke ndjekur praktikat evropiane për mbështetje gjithëpërfshirëse dhe pa stigmë.

3.3. Familja, politikat sociale dhe strehimi

a) Çfarë arritëm së bashku

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka forcuar ndjeshëm sistemin e mbrojtjes sociale dhe politikat për familjen, duke i përafëruar me standardet e Bashkimit Evropian. Shpenzimet për mbrojtjen sociale përbëjnë sot rreth 33% të buxhetit publik dhe janë orientuar kryesisht për pensione, mbrojtje të shtresave vulnerabël dhe mbështetje për familjet e reja.

Në fushën e strehimit, gjatë mandatit të fundit janë ndërtuar ose rikonstruktuar mbi 35 mijë njësi banimi, nga të cilat kanë përfutur rreth 130 mijë qytetarë. Përmes Programit Kombëtar të Strehimit Social, është zgjeruar ndjeshëm fondi publik i banesave, ndërsa Programi i Rindërtimit pas tërmetit 2019 siguroi banesa të reja dhe të rikonstruktura për mijëra familje. Një instrument tjetër i rëndësishëm ka qenë skema e kredive të lehtësuara, në mbështetje të punonjësve të arsimit, shëndetësisë dhe sigurisë publike.

Është zbatuar bonusu universal i bebes, ku mbi 240 mijë familje kanë përfutur mbështetje financiare për lindjet e reja, me një total prej mbi 182 milionë euro që nga viti 2019. Familjet janë mbështetur gjithashtu përmes teksteve shkollore falas për mbi 220 mijë nxënës dhe transportit falas për 35 mijë fëmijë dhe 12 mijë mësues.

Është reformuar skema për personat me aftësi të kufizuara sipas standardeve të OBSH-së, duke reduktuar burokracinë me 75%. Përmes Fondit Social janë financuar 84 shërbime të reja për 44,000 përfutues, ndërsa Harta Digjitale e Shërbimeve Sociale ka lehtësuar aksesin për qytetarët.

Është zgjeruar mbështetja për personat me aftësi të kufizuara, me rritje të pagesave mujore dhe shërbimeve sociale. Po ashtu, janë ngritur qendra komunitare për integrimin e tyre në arsim dhe punësim. Për familjet në nevojë, janë forcuar programet e ndihmës ekonomike, të lidhura me arsimin dhe kujdesin shëndetësor të fëmijëve.

b) Destinacioni ynë evropian

Një sistem social gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të mbështetur në integritet dhe në standardet më të avancuara evropiane. Garantojmë mbrojtje reale për çdo familje shqiptare, duke mbrojtur më të brishtët dhe siguron dinjitet e barazi shoqërore. Familja mbetet qendra e politikave sociale, duke mbështetur me strehim të përballueshëm dhe financiarisht familjet e reja dhe fëmijët e tyre.

c) Punët tona përpara

- Ndërtojmë të paktën 1,500 njësi të reja banimi me kosto të ulët deri në vitin 2029.
- Zgjerohet fondin e banesave sociale, duke përfshirë përshtatjen e ish-konvikteve dhe pronave shtetërore për strehim.
- Përdorim të ardhurat nga pasuritë e konfiskuara për të financuar programe të strehimit social.
- Zgjerohet mbështetjen sociale për personat me aftësi të kufizuara, duke garantuar akses në arsim, punësim dhe shërbime publike. Dyfishohet pagesat për fëmijët me aftësi të kufizuara duke kombinuar gjithashtu përfitimet financiare me shërbime të integruara si dhe rishikohet asistencën personale.
- Zgjerohet shërbimet për personat me spektër autizmi, duke ngritur qendra të reja për fëmijët dhe krijuar për herë të parë një qendër të dedikuar për të rriturit, për të siguruar mbështetje të specializuar dhe gjithëpërfshirëse në jetën e tyre të përditshme.
- Fuqizohet rrjetin e qendrave komunitare dhe shërbimeve sociale, në partneritet me bashkitë.
- Zhvillojmë një sistem digjital për menaxhimin e mbrojtjes sociale, për transparencë dhe gjurmueshmëri.
- Rrisim ndihmën ekonomike të lidhur me edukimin dhe kujdesin shëndetësor, duke ulur varfërinë afatgjatë.
- Ndërtojmë një paketë të re për mbështetjen e familjes së re, që përfshin subvencione për strehim dhe akses më të lehtë në kredi të buta.
- Integrojmë Shqipërinë në mekanizmat evropianë të mbrojtjes sociale, për të garantuar standarde të barabarta me BE-në.
- Zgjerohet rrjetin e shërbimeve sociale me 40 shërbime të reja për të garantuar mbulim më të mirë gjeografik.
- Rrisim shpenzimet sociale për grupet vulnerabël, në përputhje me standardet e BE-së.
- Zgjerohet programet e punësimit për gratë dhe komunitetet vulnerabël, duke ngritur 20 ndërmarrje sociale të reja në zonat rurale, që forcojnë integrimin social.
- Rrisim shërbimet për moshën e tretë, duke krijuar struktura të specializuara për kujdesin ndaj të moshuarve, asistencë shtëpiake dhe këshillim psikosocial, për të garantuar një jetë më cilësore, me dinjitet dhe mbështetje të vazhdueshme.

3.4 Pensionet

a) Çfarë arritëm së bashku

Sistemi i pensioneve është në proces modernizimi për të garantuar dinjitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Qeveria ka vendosur objektiva të qartë për rritjen e pensioneve dhe konsolidimin financiar të skemës, përfshirë luftën kundër informalitetit dhe deklarimin real të pagave, në mënyrë që kontributet të jenë të plota për çdo të siguruar. Në të njëjtën kohë, po ndërmerret digjitalizimi i plotë i sigurimeve shoqërore për të mundësuar shërbime të shpejta e të aksesueshme për qytetarët. Në planin e të ardhmes së afërt, pensioni mesatar për kontribuesit e plotë dhe pensioni minimal janë planifikuar të arrijnë respektivisht në 400 euro dhe 200 euro brenda periudhës së programit, si pjesë e forcimit të mbrojtjes sociale.

b) Destinacioni ynë evropian

Të garantohet pensione dinjitoze dhe financiarisht të qëndrueshme, të përafruara me standardet e BE-së dhe ILO-s, përmes rritjes graduale të përfitimeve, rritjes së bazës kontribuuese, digjitalizimit të plotë të sigurimeve shoqërore dhe mekanizmave të rinj të investimit për skemën e pensioneve.

c) Punët tona përpara

- Të garantohet deri në fund të vitit 2029 pension mesatar prej rreth 400 euro për kontribuesit e plotë dhe pension minimal 200 euro, si pjesë e paketës së mbrojtjes sociale.
- Digjitalizimi i plotë i sistemit të sigurimeve shoqërore (regjistër elektronik, shërbime *online end-to-end*), për transparencë dhe gjurmueshmëri.

- Ulja e informalitetit në tregun e punës përmes nxitjes së deklarimit të pagave reale dhe këshillimit sistematik të punëdhënësve/punëmarrësve, për të rritur bazën e kontributeve.

- Përdorim sistematik i bonuseve sipas zhvillimeve ekonomike.

- Pensionet do të mbulojnë rreth 40% të të ardhurave të fituara gjatë viteve të punës, deri në vitin 2030 në përputhje me standardet evropiane/ILO.

- Portabilitet ndërkufitar i përfitimeve: përfundimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë të pensioneve.

3.5 Fëmijët, rinia dhe barazia gjinore

a) Çfarë arritëm së bashku

Fëmijët janë prioritet kombëtar, ndaj politikat e dekadës së fundit janë orientuar drejt garantimit të mbrojtjes së tyre, përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore, si dhe krijimit të kushteve të barabarta për zhvillimin e potencialit të çdo fëmije. Për të ecur me hapat e zhvillimit teknologjik, kemi investuar në 300 laboratorë inteligjentë dhe kurrikula të reja të teknologjisë së informacionit dhe kodimit, nga të cilët kanë përfituar 35,000 fëmijë. Mbi 12,000 fëmijë janë angazhuar në programin e ekipeve sportive, duke e bërë sportin një komponent thelbësor të edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve. Mbi 10,000 fëmijë kanë pasur mundësinë të zbulojnë dhe zhvillojnë talentet e tyre në arte dhe zeje pas orarit mësimor.

Rinia shqiptare është një aset kombëtar, ndaj politikat e dekadës së fundit janë përqendruar në rritjen e mundësive për arsim, punësim dhe përfshirje sociale. Janë ndërtuar dhe rindërtuar 15 qendra rinore dhe biblioteka që kanë shërbyer si hapësira krijimtarie dhe aftësimi për mbi 230 mijë të rinj. Përmes fazës pilot të Garancisë Rinore, mbi 1,300 të rinj kanë përfituar mundësi punësimi, trajnimi apo arsimimi brenda 4 muajve nga regjistrimi. Përmes programit kombëtar të praktikave të punës, kemi ofruar praktikën e parë të punës për mbi 5,000 të rinj, dhe kemi angazhuar 1,700 të rinjtë më të suksesshëm si pjesë e administratës.

Programet për zhvillimin e aftësive digjitale kanë përfshirë mbi 2,000 programues të rinj, ndërsa qendra si TUMO Tirana, Ecole 42, kanë krijuar ekosisteme të reja inovacioni për brezin e ri. Të rinjtë janë përfshirë në vendimmarrje vendore dhe kombëtare, përmes këshillave rinorë lokalë dhe Këshillit Kombëtar Rinor ku marrin pjesë rreth 500 të rinj në të gjithë vendin.

Nëpërmjet mbështetjes për organizatat rinore kemi zhvilluar 84 projekte me anë të së cilëve janë zhvilluar aftësitë e 43,600 të rinjve në 61 bashki të vendit, duke përdorur metodologjinë e BE për grantdhënie.

Është forcuar legjislacioni për barazisë gjinore duke fortësuar mbrojtjen nga diskriminimi, janë rritur masat për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe në politikë, ndërsa është avancuar kuota gjinore në parlament dhe qeverisje. Skemat e mbështetjes sociale kanë synuar në mënyrë të veçantë nënat e reja dhe gratë në zonat rurale, duke lidhur politikat sociale me punësimin dhe arsimin profesional.

b) Destinacioni ynë evropian

Të konsolidojmë një ekosistem rinor gjithëpërfshirës me barazi gjinore, që përshpejton integrimin në BE: shanse të barabarta për arsim cilësor e aftësi moderne, tranzicion të shpejtë shkollë-punë, pjesëmarrje e lëvizshmëri evropiane dhe barazi në punësim, paga e përfaqësim, të mundësuar nga digjitalizimi dhe politika të bazuara në të dhëna.

c) Punët tona përpara

- Investimi në 1,000 laboratorë inteligjentë dhe shtrirja e kurrikulës së kodimit dhe inteligjencës artificiale në shkolla përgjatë gjithë arsimit parauniversitar duke modernizuar mësimdhënien e duke garantuar një mjedis inovativ për fëmijët.

- Do të nxisim dhe kultivojmë talentin e të rinjve në fushat e artit, kulturës, shkencës, dhe teknologjisë, përmes shtrirjes së programit jashtëshkollor arte dhe zeje në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar.

- Do të vijojë investimi në infrastrukturë sportive dhe shtrirjen e programit të ekipeve sportive në shkolla duke shtuar disiplinat sportive dhe numrin e shkollave pjesëmarrëse.

- Krijimi i hapësirave urbane të standardizuara me kënde lojërash multifunksionale për fëmijët dhe kujdestarët e tyre.

- Dyfishimi i qendrave rinore duke mbuluar të gjitha bashkitë e vendit me hapësira të dedikuara për krijimtari dhe inovacion.

- Mbështetja e 120 projekteve rinore nga organizatat rinore me qëllim ofrimin e më shumë mundësive për të rinjtë në fushat e kulturës, sportit, inovacionit dhe edukimit.

- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje, përmes këshillave rinorë në çdo bashki, dhe nëpërmjet programit të nismave komunitare që mbështet idetë e të rinjve.

- Mbështetja e 3,000 të rinjve nëpërmjet programit kombëtar të praktikave të punës, për eksperiencën e tyre të parë të punës në administratë, dhe punësimi i 1,250 më të mirëve.

- Mbështetja e 1,000 të rinjve të talentuar me pjesëmarrje në kompeticione dhe veprimtari ndërkombëtare në fushën e kulturës, edukimit, shkencës, teknologjisë dhe sportit.

- Idetë e mbi 2,500 të rinjve do të zbatohen në komunitetet e tyre nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike të programit të nismave komunitare.

- Zgjerimi i Garancisë Rinore me përfshirjen e mbi 40 mijë të rinjve në punësim, arsim ose trajnim deri në vitin 2030.

- Krijimi i një platforme digjitale për rininë, për të ofruar shërbime, mundësi dhe financime transparente.

- Prezantimi për herë të parë i ligjit për vullnetarizmin, i cili do të bëjë të mundur që eksperiencia vullnetare të njihet si përvojë pune.

- Zhvillimi i programeve kombëtare për aftësitë digjitale të rinisë, duke përfshirë mbi 50 mijë të rinj deri në vitin 2030.

- Përdorimi i kredive të buta dhe subvencioneve për strehim dhe financimi i sipërmarrjes rinore mes mbështetjes për themelimin e *startup*-ve rinore.

- Sigurimi i barazisë gjinore në tregun e punës, me masa për të reduktuar hendekun e pagave mes grave dhe burrave.

- Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe qeverisje, duke forcuar kuotat gjinore dhe promovuar liderшипin femëror.

- Mbështetje e dedikuar për nënat e reja dhe gratë në zonat rurale, me trajnime profesionale dhe subvencione të drejtpërdrejta.

3.6 Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike

a) Çfarë arritëm së bashku

Mbrojtja e mjedisit dhe përballja ndaj ndryshimeve klimatike janë pjesë qendrore e politikave zhvillimore të Shqipërisë. Sot, 21,6 % e territorit kombëtar është zonë e mbrojtur, ndërsa deklarimi i lumit Vjosa së Bashku me tre tributarët e tij (Drino, Bënça dhe Shushica) si i pari Park Kombëtar në Evropë i një lumi të egër e ka vendosur Shqipërinë në hartën globale të mbrojtjes së biodiversitetit.

Janë ripyllëzuar dhe shtuar sipërfaqe të gjelbra me mbi 500 mijë pemë në 150 fushata mbjelljeje në kuadër të “Vitet të Pyjeve 2024”, duke rritur sipërfaqet e gjelbra urbane dhe rurale dhe duke përmirësuar cilësinë e ajrit. Paralelisht, është përmirësuar rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit dhe janë hartuar strategji për reduktimin e ndotjes nga transporti dhe operatorët industrialë.

Në fushën e menaxhimit të mbetjeve, është shtuar dhe përmirësuar infrastruktura e trajtimit të mbetjeve me impiante të kompostimit, riciklimit si dhe ata rajonal të trajtimit fundor të mbetjeve, duke

ulur ndjeshëm edhe duke mbyllur një pjesë të madhe të venddepozitimeve të pakontrolluara. Gjithashtu përqindja e mbledhjes së mbetjeve në territorin e Republikës ka arritur në 98% duke dyfishuar dhe trefishuar në disa raste frekuencën dhe mjetet e mbledhjes së mbetjeve në bashkitë bregdetare gjatë periudhës së fluksit të lartë të sezonit turistik. Për ujërat, janë forcuar kapacitetet e monitorimit të baseneve dhe nisur hartimi i Strategjisë Kombëtare për Ujërat Detare.

Shqipëria ka miratuar ligje të reja për eficiencën e energjisë dhe biokarburantet, si dhe ka nisur zbatimin e Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave, duke e lidhur mbrojtjen e mjedisit me tranzicionin energjetik dhe uljen e emetimeve.

Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike si dhe ka nisur zbatimin e planeve vendore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike duke krijuar mundësinë e mitigimit të efekteve nëpërmjet masave të prioritizuara për 5 sektorët kryesorë, si: energjia, transporti, turizmi, bujqësia dhe zhvillimi urban.

b) Destinacioni ynë evropian

Objektivi ynë është që deri në vitin 2030, Shqipëria të jetë një shembull evropian i zhvillimit të qëndrueshëm në mbrojtjen e mjedisit dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, përmes forcimit të sistemeve të mbrojtjes, rritjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe integritit të plotë me politikat e gjelbra të BE-së.

Ky vizion nënkupton hartimin dhe zbatimin e politikave sektoriale në zhvillimin e qëndrueshëm, tranzicioni drejt ekonomisë qarkulluese reduktim të emetimeve dhe garantim të një mjedisi të shëndetshëm për qytetarët, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Agjendën 2030 të BE-së.

c) Punët tona përpara

- Krijimi i ekonomisë qarkulluese në rang vendi me një Operator Kombëtar të Trajtimit të Integruar të Mbetjeve dhe me investime në të gjitha zonat e menaxhimit të mbetjeve.

- Rrisim riciklimin dhe kompostimin, shtojmë venddepozitimet sanitare, mbyllim pikat e papërshtatshme historike dhe mbajmë bashkitë të pastra.

- Forcojmë kontrollin e territorit dhe zbatojmë standardet BE mbi përgjegjësinë mjedisore sipas parimit “Ndotësi paguan” dhe luftën ndaj krimit mjedisor.

- Ndërtojmë sistemin e ri digjital të integruar i të dhënave mjedisore për gjurmim “real- time”.

- Përmirësojmë menaxhimin e integruar të burimeve ujore duke shtuar kapacitetet e monitorimit në të gjitha basene dhe ujërat detare.

- Përmirësojmë sistemin e të dhënave mjedisore nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja dhe integrim të burimeve vendore/qendrore.

- Rrisim pyllëzimin: dokumente kornizë dhe kadastra e zonave të mbrojtura; rimbjellje e zonave të prekura nga zjarret.

- Harmonizojmë politikat klimatike në të gjithë sektorët për ulje të emetimeve dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike.

3.7 Pushteti vendor dhe zhvillimi rajonal

a) Çfarë arritëm së bashku

Një dekadë pas reformës administrativo-territoriale, pushteti vendor është konsoliduar si një shtyllë thelbësore e qeverisjes demokratike dhe ofrimit të shërbimeve publike. Kalimi nga 373 njësi vendore në 61 bashki ka sjellë rritje të kapaciteteve administrative, rritje të eficiencës financiare dhe standardizim të shërbimeve. Buxheti i pushtetit vendor është rritur ndjeshëm, ndërsa bashkitë kanë përfituar mbështetje teknike dhe financiare për digjitalizim dhe modernizimin e administratës vendore.

Janë hedhur bazat për integrimin e pushtetit vendor me procesin e anëtarësimit në BE, përmes përgatitjes së tyre për të përthithur fondet e kohezionit dhe programet e zhvillimit rajonal. Përmes mbështetjes së Bankës Botërore dhe partnerëve evropianë, synohet vendosja e sistemit të ri të

menaxhimit financiar vendor të integruar me thesarin e shtetit, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien.

Në nivelin e zhvillimit të rajoneve, janë bërë hapa të rëndësishëm për përgatitjen e kornizës NUTS dhe për ndërtimin e kapaciteteve të programimit rajonal, duke hapur rrugën për përdorimin e fondeve të BE-së në zhvillimin territorial. Po ashtu, është nisur Akademia e Pushtetit Vendor, me synimin për të trajnuar mijëra punonjës të bashkive.

b) Destinacioni ynë evropian

Një qeverisje vendore moderne, e fuqizuar financiarisht e profesionalisht, si dhe e gatshme për zbatimin e politikave të kohezionit të BE-së, duke garantuar zhvillim të balancuar rajonal dhe shërbime publike cilësore për çdo qytetar.

Ky vizion lidhet drejtpërdrejt me procesin e anëtarësimit në BE dhe synon që bashkitë të jenë aktorë kryesorë të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor.

c) Punët tona përpara

- Reforma e re administrative territoriale 2.0 dhe përshtatja e saj me standardet e BE-së deri në vitin 2027.

- Forcojmë kapacitetet sipërmarrëse të bashkive përmes një ligji të ri për shoqëritë vendore dhe qeverisjen e ndërmarrjeve publike lokale.

- Sigurojmë shërbime më të aksesueshme nga qytetarët duke riinxhinuar dhe digjitalizuar dhe shërbimet vendore sipas modelit *e-Albania*.

- Fuqizojmë financiarisht dhe nxisim performancën e bashkive duke rishikuar formulën e transfertës së pakushtëzuar dhe prezantimin e grantit të performances.

- Mbështesim përrthithjen e fondeve të BE-së përmes forcimit të njërive të integritetit evropian në çdo bashki, për të zbatuar standardet e BE-së dhe për të përrthithur fondet e kohezionit.

- Fuqizojmë kapacitetet profesionale vendore, duke krijuar Akademinë e Pushtetit Vendor si një qendër trajnimi dhe zhvillimi për mbi 4 mijë punonjës vendorë.

- I japim më shumë fuqi bashkive duke zgjeruar decentralizimin në fusha si arsimi, shëndeti dhe shërbimi këshillimor bujqësor.

- Nxisim bashkitë të kthehen në agentë të zhvillimit ekonomik duke hartuar plane lokale të zhvillimit ekonomik vendor me përfshirjen e universiteteve dhe qendrave kërkimore.

- Forcojmë deokracinë vendore, përmes transparencës dhe llogaridhënies dhe të dhënave të hapura (*open data*), me tregues të matshëm mujorë dhe përfshirje të qytetarëve në monitorim.

3.8 Sporti

a) Çfarë arritëm së bashku

Gjatë dekadës së fundit sporti është shndërruar nga një sektor i lënë pas dore në një shtyllë të zhvillimit social e shëndetësor, me investime në infrastrukturë dhe rritje të mundësive për fëmijët e të rinjtë. Investuam në ndërtimin e 150 terreneve sportive në shkolla e komunitete, ndërsa stadiumet si “Air Albania”, “Elbasan Arena”, në Shkodër e Kukës përmbushin standardet FIFA/UEFA.

Programi i ekipeve sportive në shkolla ka rezultuar histori suksesi dhe parashikohet të vijojë zgjerimi në numër disiplinash dhe investime vjetore në infrastrukturë, për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete sportive. Në politikën sektoriale, sporti trajtohet si pjesë thelbësore e edukimit, shëndetit dhe kulturës shoqërore.

b) Destinacioni ynë evropian

Të forcojmë sportin si politikë publike horizontale për shëndetin, edukimin dhe kohezionin shoqëror, duke rritur pjesëmarrjen masive, duke zhvilluar talentin me infrastrukturë sportive dhe kushte të standardeve ndërkombëtare dhe duke garantuar përfshirje të barabartë, dhe duke përfshirë dhe infrastrukturë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

c) Punët tona përpara

- Ndërtojmë 4 stadione të reja në Tiranë, Durrës, Korçë dhe Vlorë, me standarde të unifikuara për sportin profesionist.
- Themelojmë akademitë sportive sipas modeleve më të mira ndërkombëtare Manchester City, Rafael Nadal dhe NBA për zbulimin dhe zhvillimin e talenteve.
- Investojmë në ndërtimin e 200 palestrave dhe terreneve të reja sportive në shkolla, duke garantuar akses të barabartë për çdo nxënës në hapësira moderne për edukim dhe aktivitet fizik.
- Zgjerojmë programin kombëtar “Ekipet sportive në Shkollë” me disiplina të reja sportive, duke aktivizuar më shumë se 20 mijë nxënës në shkollë.
- Krijojmë Komitetin Paraolimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpikun Special Shqiptar si dhe rrisim mbështetjen për sportistët elitarë e federatat, për përgatitje në garat ndërkombëtare.
- Ndërtojmë infrastrukturë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara, duke mundësuar përfaqësimin në olimpiadat speciale dhe paraolimpike.
- Shqipëria do të mikpresë gjithnjë e më shumë ngjarje sportive ndërkombëtare, duke u shndërruar në një qendër rajonale të sportit. Këto angazhime do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në promovimin e potencialeve ekonomike, turistike dhe kulturore të vendit, duke e vendosur Shqipërinë në hartën e organizimit të eventeve të mëdha sportive.

3.9 Kultura

a) Çfarë arritëm së bashku

Në dhjetë vjetët e fundit, kemi kthyer kulturën në një prioritet kombëtar, duke e vendosur në qendër të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Me investime të qëndrueshme, kemi transformuar trashëgiminë kulturore, infrastrukturën artistike dhe jetën kulturore në çdo cep të Shqipërisë.

Realizuar 650 restaurime në objekte të trashëgimisë kulturore, katër herë më shumë se qeveria e mëparshme, ndërsa rijetëzuar 7 qendra historike, duke i kthyer ato në motor zhvillimi turistik e ekonomik. Pazari i Ri, Kruja, Gjirokastra, Vlora, Berati dhe Korça janë sot shembulli i kësaj rilindjeje kulturore.

Rindërtuar 10 teatro dhe 20 muze, ndërsa rikonstrukcioni i Teatrit Kombëtar të Operës, ndërtimi i Arturbina-s dhe modernizimi i Galerisë Kombëtare kanë hapur një epokë të re për artin skenik dhe pamor. Janë mbi 1.5 milionë vizitorë që vizitojnë *sit*-et kulturore dhe muzetë çdo vit, shtatë herë më shumë se më 2013.

Trashëgimia shqiptare është njohur botërisht, me përfshirjen e Xhubletës, Kërcimit të Tropojës dhe Transhumancës në listën e UNESCO-s, duke forcuar identitetin tonë kulturor.

Mbështetja për artistët ka qenë konkrete. Kemi rritur me 60% pagat në institucionet publike, kemi financuar mbi 1,800 projekte të skenës së pavarur dhe kemi krijuar programe të posaçme për krijimtarinë artistike.

Javët kulturore ndërkombëtare kanë kthyer Shqipërinë në një qendër të rëndësishme kulturore në rajon, duke sjellë diversitet artistik nga e gjithë bota dhe duke promovuar kulturën shqiptare jashtë kufijve.

b) Destinacioni ynë evropian

Të kthejmë kulturën në motor zhvillimi ekonomik e turistik, duke rijetëzuar trashëgiminë dhe fuqizuar industrinë krijuese, si dhe duke rritur ndërkombëtarizimin dhe rrjetëzimin e saj, për ta kthyer Shqipërinë epiqendrën kulturore të rajonit dhe një aktor aktiv në hapësirën evropiane.

c) Punët tona përpara

- Modernizojmë Muzeun Historik Kombëtar dhe hapim 7 muze të reja (Arte të Bukura, Arkeologjik Durrës dhe Korçë, Hebraik, Italian, Filmit, “Besa”, Arbëresh në Vuno).

- Ndërtojmë Teatrin e ri Kombëtar dhe përfundojmë Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë me standarde bashkëkohore.

- Rikualifikojmë destinacionet historike e kulturore, duke i kthyer në motor ekonomik për turizmin kulturor.
- Ngremë 10 hapësira të reja për librin dhe artin deri në vitin 2030 dhe integrojmë edukimin kulturor në shkolla e universitete.
- Përmirësojmë Statusin e Artistit dhe krijojmë skema financiare të reja për mbështetjen e krijimtarisë artistike.
- Dyfishojmë eventet dhe trefishojmë publikun brenda katër vjetëve, duke fuqizuar industrinë kreative si motor të turizmit.
- Ngremë Qendra Kulturore Shqiptare në Itali, Greqi, Francë, Gjermani, Angli e SHBA për të promovuar kulturën shqiptare jashtë vendit.
- Krijojmë Fondacionin “CulturAlb” për zhvillimin e industrisë krijuese dhe mbështetjen e artizanëve.
- Vendosim sistem të unifikuar digjital biletimi për *shtë* dhe muze, si dhe digjitalizojmë arkivat kulturore.
- Krijojmë Agjencinë Kombëtare të Menaxhimit të Pasurive Kulturore dhe Qendrën Kombëtare për Artin dhe Kulturën për menaxhim më efikas e transparent.
- Restaurojmë monumente të degraduara, rijetëzojmë rrjetin e kinoteatrove dhe nisim “Itinerarin e 100 kullave” për zonat veriore.
- Hartojmë Strategjinë Kombëtare të Artit dhe Kulturës 2026–2030 dhe miratojmë paketën e re ligjore për kinemanë, teatrin, librin, sponsorizimin dhe pasaportën e artistit.